

Dilema dhe ngecje në rrugën e shpejtë

Privatizimi i ndërmarrjeve publike në Kosovë

Raport hulumtues

Tetor, 2009

Autorë:

Muhamet Mustafa, Universiteti AAB-RIINVEST
Prof. Dr. Iraj Hashi, Staffordshire University
MSc. Alban Hashani, PhD Cand., Universiteti AAB-RIINVEST (koordinatori)
Dr. Jur. Korab Sejdiu, Universiteti AAB-RIINVEST
MSc. Alban Zogaj, Riinvest Institute
Sejdi Osmani, Riinvest Institute
Saxhide Mustafa, Riinvest Institute

Rastet studimore:

Entela Shehaj, Phd – Rasti i Shqipërisë
Hyrije Abazi PhD Cand. – Rasti i Maqedonisë

Ky projekt është mbështetur nga Balkan Trust for Democracy (BTD)
dhe NLB- Prishtina

Projekti është iniciuar përmes aktiviteteve të programit të Forumit 2015



PËRMBAJTJA

- 5** PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
- 9** HYRJE
- 11** ANALIZA E KORNIZËS LIGJORE PËR PRIVATIZIMIN E NDËR MARRJEVE PUBLIKE
 - 2.1 Korniza ligjore për privatizimin e ndërmarrjeve publike
 - 2.1.1. Privatizimi
 - 2.1.2. Partneriteti publiko-privat dhe koncesionet
 - 2.2 Analiza e kornizës ligjore në lidhje me privatizimin
- 19** PRIVATIZIMI DHE KONCESIONIMI I KOMPANIVE STRATEGJIKE NË EKONOMITË E TRANZICIONIT
 - 3.1 Privatizimi i infrastrukturës përmes koncesioneve
 - 3.2 Privatizimi i shërbimeve të telekomunikimit
 - 3.2.1 Mësimet e nxjerra nga privatizimi i kompanive të Telekomunikacionit në vendet në tranzicion
 - 3.2.2. Aktivitetet dhe çështjet lidhur me privatizimin e Telekomunikacionit në Kosovë (Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës)
 - 3.3 Privatizimi i sektorit të energjisë
 - 3.3.1 Mësimet e nxjerra nga privatizimi i sektorit të energjisë në ekonomitë e tranzicionit
 - 3.3.2 Aktivitetet dhe çështjet lidhur me privatizimin e sektorit të energjisë në Kosovë (Korporata Energjetike e Kosovës – KEK)
 - 3.4 Koncesionimet e Aeroportit
 - 3.4.1 Mësimet e nxjerra nga koncesionimet e aeroporteve në Ekonomitë në Tranzicion
 - 3.4.2. Aktivitetet dhe Çështjet e ndërlidhura me Koncesionimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës (ANP)
- 41** PËRMBLEDHJE E KONKLUZIONEVE:
- 43** Shtojcat
 - Shtojca 1
 - Shtojca 2:
 - Shtojca 3:
- 57** Referencat dhe bibliografia

SHKURTESAT

AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
ANP	Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës
ART	Autoriteti Rregullues i Telekomunikacionit
BOO	Ndërto, Posedo dhe Opero
BOT	Ndërto, Opero dhe Transfero
BTD	Balkan Trust for Democracy
DBFOT	Dizajno-Ndërto-Finaco-Opero-Transfero (Design-Build-Finance-Operate-Transfer)
FYROM	ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
KASH	Kornizën e fundit Afatmesme të Shpenzimeve
KEEJ	Komititetin e Energjisë për Evropën Juglindore
KEK	Korporatën Energjetike të Kosovës
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut
KQP	Komisioni Qeveritar për Privatizim
KQP	Komiteti Qeveritar për Privatizim
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MTPT	Ministria e Transportit dhe Post-telekomunikacionit
NP	Ndërmarrjet Publike
NSH	Ndërmarrjet Shoqërore
PPP	Partneriteti Publiko-Privat
PPP-KNM	Komiteti Drejtues Ndërmarrës për Partneritet Publiko Privat
PTK	Postën dhe Telekomini e Kosovës
SB	Blerësi i vetëm (Single Buyer)
SHA	Shoqëri Aksionare
TPA	Qasja e Palëve të Treta (Third Party Access)
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport hulumtues ka për qëllim që të (a) përmirësoj informimin e vendimarrësve politikë dhe palëve tjera të interesuara lidhur me situatën e tanishme në NP-të, lidhur me nevojën e privatizimit të tyre duke marrë parasysh edhe përvojat e vendeve tjera në tranzicion dhe (b) të nxis përmirësimin e transparencës, llogaridhënës dhe në mënyrë të veçantë të inkurajoj politikatat publike që synojnë përfundimin e suksesshëm të këtij procesi të rëndësishëm.

Motivimi kryesor prapa këtij raporti qëndron në atë se qeveria ka filluar të lëvizë përpara në këtë proces pa konsultime të mjaftueshme që rezultuan në shumë shqetësime gjatë dy viteve të fundit. Fillimisht Qeveria paralajmëroj se do të përfundonte shpejtë privatizimin gjatë viteve 2008-2009. Opinioni publik si dhe mediat elektronike kishin mendime pro dhe kundër këtij procesi duke ngritur pyetje si këto në vazhdim: (1) A është kjo koha e duhur për privatizimin e shpejtë të tri NP-ve kryesore duke pasur parasysh krizën globale financiare? (2) A është duke zbatuar qeveria modelet/metodat më të mira në këtë proces dha a ka nxjerrë leksione nga përvojat e vendeve tjera? (3) A ekzistojnë procedura të duhura që sigurojnë transparencën dhe llogaridhënien? (4) Si do të përdoren fondet e grumbulluara nga privatizimi dhe së fundi (5) A ekziston kuadri i duhur ligjor që të siguroj privatizimin fer, transparent dhe llogaridhënës.

Përkundër këtyre shqetësimeve, nuk ka pasur debat të mirëfilltë dhe me themel të iniciuar nga institucionet publike (Parlamenti dhe Qeveria) apo nga palët tjera të interesuara, shoqëria civile apo qarqet akademike. Në fakt ka ekzistuar përshtypja se qeveria ka tentuar që të mbajë këtë çështje brenda qarqeve të ngushta. Kjo duhet tejkaluar duke organizuar debate të gjëra publike në shoqëri. Këto debate duhet të synojnë krijimin e një konsensusi bazik ndërmjet aktorëve kyç dhe palëve të interesuara në këtë proces. Ky është një parakusht për të siguruar përkrahjen e nevojshme politike për këtë proces të rëndësishëm dhe shmangien e tensioneve të mundshme politike dhe shoqërore që do të mund ta komprometonin këtë politikë dhe do të vononin privatizimin e NP-ve. Autorët e këtij raporti besojnë se privatizimi i NP-ve është më se i domosdoshëm dhe ndoshta tepër i vonuar dhe se ky proces duhet të jetë i bazuar në kuadër të përshtatshëm ligjor i cili siguron politika dhe procedura adekuate, siguron transparencë dhe llogaridhënie dhe kontribuon në përshtetimin e rritjes ekonomike dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Raporti është fokusuar në mënyrë të veçantë në tri ndërmarrjet kyçe: Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), Postën dhe Telekomin e Kosovës (PTK) dhe Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës (ANP) duke pasur parasysh rëndësinë e tyre në zhvillimin ekonomik dhe social. Raporti është përgatitur duke përdorur të dhëna sekondare të plotësuara me të dhëna primare nga intervistat gjysmë të strukturuar me menaxherët e NP-ve, ministrat e linjës dhe Ministrin e Ekonomisë dhe Financave që është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit. Për më tepër, janë marrë për bazë dhe mendimet e ekspertëve të kësaj fushe. Të dhënat sekondare të përdorura në këtë raport përfshijnë raportet hulumtuese të Riinvestit, ministritë e linjës, NP-ve raportet e institucioneve tjera relevante dhe punimet shkencore që janë përdorur për të trajtuar pjesën teorike të raportit dhe përvojat e vendeve tjera në tranzicion. Raporti gjithashtu prezanton dy raste të detajuara studimore që trajtojnë privatizimin e këtyre industrive strategjike në Shqipëri dhe Maqedoni.

Deri në qershor të vitit 2009, NP-të në Kosovë ishin administruar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM), mirëpo pas hyrjes në fuqi të kushtetutës së Kosovës, këto ndërmarrje janë transferuar nën administrimin e qeverisë së Kosovës. Në bazë të kuadrit të tashëm ligjor, qeveria e Kosovës ka vendosur që të rishtrukturojë KEK-un dhe të privatizojë distribuimin dhe furnizimin të cilat paraprakisht do të shndërrohen në entitete të veçanta ligjore. Qeveria e Kosovës gjithashtu ka autorizuar në mënyrë zyrtare procesin e krijimit të partneritetit publiko-privat për operacionalizimin dhe zgjerimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës (ANP) gjithashtu Qeveria ka treguar vendosmërinë e saj për të futur pronësinë private në Postën dhe Telekomun e Kosovës për të cilën së fundi është hapur konkursi nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave për të angazhuar këshilltarin e transaksionit.

Përfundimet kryesore nga ky raport hulumtues janë:

- Qeveria e Kosovës qartësisht ka shfaqur vendosmërinë e saj për të privatizuar në mënyrë të shpejtë dhe energjike këto tri ndërmarrje strategjike. Ndonëse vendosmëria e Qeverisë duhet të vlerësohet, shihet se megjithatë kjo është në nivelin e përgatitjeve, krijimit të kuadrit të qëndrueshëm ligjor, krijimit të përkrahjes së nevojshme politike dhe publike si dhe krijimit të një konsensusi themelor në Kuvendin e Kosovës dhe me aktorët tjerë shoqëror. Siç po provohet, një mjedis i tillë nuk ka shkuar në favor të arritjeve të qëndrueshme në këtë fushë (përveq lëvizjeve të fundit në ANP)).
- Korniza e tanishme ligjore ofron vetëm zgjidhje bazike për të filluar procesin e privatizimit të NP-ve. Politikat dhe procedurat nuk janë të qarta. Siç duket Komiteti Qeveritar për Privatizim (KQP) dhe Komiteti Drejtues Ndërmintor për Partneritet Publiko Privat (PPP-KNM) ka kompetenca shumë të gjera dhe nga ana tjetër mbikëqyrja ndaj tij dhe raportimi ndaj Kuvendit të Kosovës nuk është siguruar.
- Qeveria nuk ka politika të qarta lidhur me rishtrukturmimin pronësor të NP-ve pas fazës së parë të privatizimit; nëse do të shes të gjitha akcionet tek investitori privat apo do të mbajë një pjesë të tyre në pronësi publike për privatizim të mëvonshëm eventual apo do të ndjek rrugën e mbajtjes së "aksionit të artë" (Golden Share).
- Qeveria nuk ka politika dhe përcaktime se si do të përdoren fondet e mbledhura nga privatizimi i NP-ve. Aspektet kyçe të kësaj çështjeje duhet të jenë pjesë e debatit shoqëror: në parlament, qarqe akademike dhe shoqëri civile. Pasi që këto ndërmarrje i shërbejnë interesit të gjerë të qytetarëve, të gjeneratave të tashme por edhe të atyre të ardhshme, ne konsiderojmë se lidhur me këtë duhen përcaktuar zgjidhje dhe politika të qëndrueshme.

Rekomandime:

- Ne rekomandojmë që qeveria e Kosovës dhe Parlamenti në një të ardhme të afërt të kompletojnë kuadrin aktual ligjor që të sigurojnë privatizim efikas, transparent dhe llogaridhënës të NP-ve përmes amandamentimit të ligjeve ekzistuese mbi NP-të dhe PPP-të dhe koncesionet apo duke nxjerrë ligje të veçanta për privatizimin e secilës nga këto ndërmarrje publike: KEK, PTK dhe ANP.
- Kuvendi i Kosovës duhet të jetë i angazhuar në mënyrë më aktive që të

fuqizojë pozicionin e tij në këtë proces i cili do të siguronte transparencën dhe llogaridhënien e qeverisë dhe organeve tjera për të mundësuar përfundim të suksesshëm të këtij procesi. Autorizimet e Komisionit Qeveritar të Privatizimit dhe Komisionit Ndërministror të Partneritetit Publiko-Privat, duhet të peshohen me kujdes dhe rishqyrtohen në këtë kontekst. Kjo duhet të sigurohet qartësisht përmes kompletimit të kuadrit ligjor.

- Duke marrë për bazë përvojat e vendeve tjera në tranzicion, ne sugjerojmë që një pjesë e aksioneve, deri në masën që nuk dekurajon investitorët, të mbahet në pronësi publike në fazën fillestare të privatizimit të NP-ve në mënyrë që të eventualisht të mund të shiten me çmim më të lartë në fazat e mëvonshme.
- Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës përmes debatit gjithëpërfshirës me aktorët tjerë duhet të ndërtoj politikë që sigurojnë se një pjesë e mirë e mjeteve që vijnë nga privatizimi, përveç shpenzimeve të transaksionit, duhet të shfrytëzohen për investime publike në infrastrukturë, arsim dhe shëndetësi dhe jo të përdoren si pjesë e buxhetit për paga dhe mëditje apo mallra dhe shërbime.
- Ne rekomandojmë që gjatësia e marrëveshjeve koncesionare duhet të përcaktohet me kujdes dhe se koncesionimi me kohëzgjatje 40 vjeçare është një përjashtim për projekte të veçanta (si p.sh. rrjete infrastrukturore, pylltari etj) dhe se aranzhmanet që paraqesin transaksione të mëdha dhe në rastet kur kohëzgjatja e koncesionit kalon periudhën 20-25 vjeçare, duhet të aprovohet nga Kuvendi i Kosovës.

HYRJE

Synimi për privatizimin e tri ndërmarrjeve më të mëdha publike (NP) në Kosovë, KEK, PTK dhe ANP ka filluar të realizohet pas vendimit të Qeverisë së Kosovës, të marrë në pajtim me kornizën ekzistuese ligjore aktuale. Këto NP ofrojnë shërbime që janë esenciale për cilësinë e jetës së qytetarëve të Kosovës. Mënyra e privatizimit të tyre dhe rezultatet e këtij procesi të rëndësishëm do të prekin interesat e secilit qytetar. Duke u nisur nga rëndësia e privatizimit të NP-ve në Kosovë, Instituti Riinvest synon që me këtë raport hulumtues të krijojë kushte për një debat cilësor dhe të angazhuar midis akterëve relevantë, siç janë Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës, shoqëria civile, qarqet akademike dhe opinioni i gjerë.

Instituti Riinvest është angazhuar vazhdimisht nëpërmjet hulumtimeve të tija dhe avokimit në favor të një procesi efektiv të privatizimit në Kosovë. Gjatë periudhës 2001-2008 Riinvesti ka publikuar pesë raporte që adresojnë procesin e privatizimit me problemet dhe të arriturat e tij në Kosovë. Këto raporte përmbajnë argumente teorike dhe praktike për në favor të privatizimit të NSH-ve dhe NP-ve në Kosovë. Ato gjithashtu vejnë në pah efektet negative të hezitimeve dhe vonesave që e kanë shoqëruar këtë proces, e gjithashtu edhe rezultatet e arritura deri me tani.

Në vazhdimësi të raporteve kërkimore që kryesisht kanë trajtuar privatizimin e NSH-ve, që nga korriku i sivjetmë, Riinvesti ka filluar projektin kërkimor për hartimin e këtij raporti, për të ndriçuar aspektet kyçe lidhur me privatizimin e NP-ve në Kosovë. Privatizimi i NP-ve, të cilat kanë gëzuar një pozicion të plotë monopolist në Kosovë (me përjashtim të PTK-së, e cila e humbi këtë pozicion, pas hyrjes së konkurrencës në këtë treg), është i lidhur me eficiencën e ofrimit të shërbimeve dhe gjithashtu edhe me eficiencën teknike (operacionale) të këtyre sektorëve. Në këtë drejtim, është e rëndësishme që praktika rregullative të fuqizohet, për të garantuar se fuqia e monopolit nuk do të keqpërdoret. Ky raport është përgatitur nga Instituti Riinvest me përkrahje gjeneroze nga Balkan Trust for Democracy (BTD), si pjesë e German Marshal Fund dhe pjesërisht edhe nga NLB e Prishtinës. Po ashtu, ky raport është në linjë me programin e "Forumit 2015" në lidhje me krijimin e një platforme për një debat konstruktiv për fusha të caktuara midis aktorëve kryesorë në shoqërinë kosovare në kuadër të agjendës për integritime Euro- Atlantike.

Ky raport synon që (a) të përmirësojë informimin e vendim-marrësve dhe akterevë tjerë në shoqëri lidhur me situatën aktuale të NP-ve dhe nevojën për privatizim të tyre, duke marrë parasysh po ashtu edhe përvojat e vendeve tjera në tranzicion dhe (b) për të nxitur një përmirësim të transparencës e përgjegjësisë dhe veçanërisht për të inkurajuar politikant publikë me qëllim të përfundimit të suksesshëm të këtij procesi të rëndësishëm.

Motivi kryesor për hartimin e këtij raporti qëndron në faktin se derisa qeveria ka ecur përpara me këtë proces, pa konsultime të mjaftueshme, në opinion janë ngritur shumë shqetësime gjatë dy viteve të fundit. Qeveria në fillim ka paralajmëruar se privatizimi do të përmbyllet gjatë viteve 2008-2009. Opinioni publik, mediet elektronike dhe shtypi, kanë shfaqur mendime për dhe kundër dhe kanë ngritur dilema e çështje si: (1) A është kjo koha më e mirë për një privatizim të shpejtë të tri NP-ve kryesore, duke marrë parasysh krizën globale financiare? (2) A po e zbaton qeveria

modelin më të mirë dhe a ka mësuar ajo nga mësimet dhe nga përvojat e vendeve tjera? (3) A janë vendosur procedura të drejta të transparencës dhe përgjegjësisë (4) Si do të përdoren fondet e krijuara nga privatizimi dhe në fund (5) A ka një kornizë të domosdoshme ligjore në fuqi për të siguruar një privatizim të drejtë, transparent dhe llogaridhënës.

Me gjithë këto brenga, deri me tani nuk ka pasur një debat cilësor, të iniciuar nga institucionet publike (Kuvendi dhe Qeveria) ose nga akterët tjerë, shoqëria civile apo academia. Në fakt, ka pasur përshtypje se qeveria po përpiqet ta mbajë këtë debat brenda qarqeve relativisht të ngushta. Kjo duhet tejkaluar duke hapur debate gjithëpërfshirëse në shoqëri nëpërmjet të cilave do të duhej të arrihej një konsensus midis aktorëve kyç të ndërlidhur me këtë çështje. Ky është një parakusht për të garantuar përkrahje të domosdoshme politike për këtë proces të rëndësishëm dhe për të evituar tensionet eventuale politike dhe sociale që mund të komprometojnë procesin e edhe të vonojnë privatizimin e NP-ve. Autorët e këtij raporti besojnë se privatizimi i NP-ve është më shumë se i domosdoshëm dhe i vonuar madje. Ata insistojnë po ashtu se ky proces duhet të mishërohet në një kornizë adekuate ligjore e cila do të sigurojë aplikimin e procedurave dhe politikave adekuate të transparencës dhe llogaridhënies, për të kontribuar në përshpejtimin e rritjes ekonomike dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Raporti është organizuar siç vijon: Pjesa e parë përfshinë kornizën ligjore për privatizimin e NP-ve në Kosovë. Pjesa e dytë përshkruan përvojat e ekonomive tjera në tranzicion me privatizimin dhe koncesionimin e industrive të ngjashme dhe situatën aktuale në PTK, KEK dhe ANP. Shtojcat përfshijnë dy studime rasti nga Shqipëria dhe Maqedonia me rastin e privatizimit të kompanive të ngjashme.

Metodologjia:

Ky raport është përgatitur në bazë të të dhënave primare dhe sekondare. Ne kemi ndërmarrë një hulumtim duke shfrytëzuar burime relevante, përfshirë edhe analizën e raporteve ekzistuese dhe informacionet tjera në dispozicion nëpër ueb-faqe. Ne jemi fokusuar në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), Postën dhe Telekomunikacionin e Kosovës (PTK) dhe Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës (ANP). Hulumtimi i secilit rast ka rezultuar me një seri pyetjesh të cilat përbëjnë bazën e pyetësorit gjysmë të strukturuar i cili u përdor gjatë intervistimit të menaxherëve dhe njerëzve me përgjegjësi në ministrinë përkatëse dhe në NP-te. Autorët shprehin keqardhjen që, gjatë përgatitjes së këtij raporti, me gjithë përpjekjet e shpeshta, nuk kanë arritur një mirëkuptim dhe bashkëpunim që ta organizojnë një takim me drejtorin menaxhues të PTK-së apo ndonjë person tjetër përgjegjës të autorizuar nga ai.

Autorët e raportit shprehin falënderime për ministrat Ahmet Shala, MEF; Justina Pula, MEM; Fatmir Lima, MTPT si dhe për drejtorët menaxhues të NP-ve (z. Arben Gjukaj, KEK dhe z. Agron Mustafa, ANP) që ndanë me ne opinionet dhe konsideratat e tyre për këtë çështje. Dy studime rasti që adresojnë privatizimin në industritë e ngjashme në Shqipëri dhe Maqedoni janë përgatitur nga konsulentët tanë (Entela Shehaj, PhD dhe Hyrija Abazi PhD Cand. respektivisht) në bashkëpunim me ekipin e projektit. Riinvesti falënderon të gjitha palët e përfshira në përgatitjen e

këtij raporti për kontributin e tyre, ndërsa merr gjithë përgjegjësinë për gjetjet dhe konkluzionet e raportit. Po ashtu, do të donim të falënderonim profesor Iraj Hashi nga Staffordshire University, Mbretëria e Bashkuar për kontributin e tij në këtë projekt, veçanërisht për kontributin në pjesën ku raporti merret me privatizimin përmes koncesionimeve. Gjithashtu duam të falënderojmë BTD-ne dhe NLB-ne të Prishtinës për mbështetjen e këtij projekti si dhe "Forum 2015" që inicioi këtë hulumtim dhe këtë debat.

2. ANALIZA E KORNIZËS LIGJORE PËR PRIVATIZIMIN E NDËRMARRJEVE PUBLIKE

Konstatime të përgjithshme

Është dëshmuar se privatizimi i ndërmarrjeve publike (NP) të jetë proces i ndërlikuar pa marrë parasysh se për cilën pjesë të botës bëhet fjalë. Sidoqoftë NP-të, kur paraqitet nevoja, duhet të privatizohen për një sërë arsyesh, duke përfshirë, por jo vetëm këto, përmirësimin e performancës dhe efikasitetin, nevojën e zhvillimit dhe strategjive që nuk janë detyruesisht të sigurta politikisht, forcimin e përgjegjësisë dhe frenimin e korrupsionit, rritjen e disiplinës dhe përgjigjes ndaj tregut dhe zvogëlimin e ndikimit politik.

Mënyra më e mirë për zbutjen e vështirësive potenciale lidhur me privatizimin e NP-ve është përgatitja e një kornize ligjore adekuate dhe zotimi i institucioneve qeveritare për implementimin e saj. Natyrisht, edhe për implementimin e çfarëdo projekti të madh, përgjegjësia dhe transparenca e plotë janë parakushte të domosdoshme për arritjen e çfarëdo suksesi.

Republika e Kosovës ka miratuar disa ligje që kanë të bëjnë në ndonjë mënyrë me privatizimin e NP-ve dhe mbetet të shihet nëse ky legjislacion është i mjaftueshëm dhe çka është më e rëndësishmja, nëse një legjislacion i tillë do të gjejë implementim të plotë. Një analizë e legjislacionit që ka mbështetur atë që u përmend më lartë ofrohet në këtë shkrim. Sikurse që do të nënkuptohet nga analizat e bëra, korniza ligjore që është menduar të drejtojë privatizimin e NP-ve ka anët e veta pozitive por edhe ato negative.

Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore

Republika e Kosovës ka pasur disa përvoja me privatizimin, veçanërisht në lidhje me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore (NSH). Privatizimi i NSH-ve ka arritur përparim të konsiderueshëm, por edhe në disa aspekte ka qenë, në rastin më të mirë, një proces i pasigurt. Në të vërtetë kjo ndodhi në një kohë të pasigurisë në lidhje me pronësinë mbi NSH-të. Pa u thelluar në shumë detaje, privatizimi i NSH-ve ishte drejtuar nga UNMIK-u (i cili e përgatiti kuadrin e nevojshëm ligjor) dhe është zbatuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM), duke njohur statusin e tyre pronësor si NSH të Kosovës dhe deri në një masë edhe të punonjësve të tyre.

Shumica e NSH-ve janë privatizuar tashmë sipas kuadrit të tillë ligjor dhe nga autoritetet e theksuara më lartë. Pas shpalljes së Kosovës shtet sovran dhe të pavarur, u ndërmorën disa hapa në drejtim të miratimit të një kornize të re ligjore, siç është Ligji mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me të cilin themelohet pasardhësi i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit-Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP). Sipas këtij ligji të ri, AKP-së i është dhënë autoritetin për të administruar dhe në këtë mënyrë edhe për privatizimin e NSH-ve në Kosovë. Në këtë mënyrë, AKP-ja vazhdoi privatizimin e NSH-ve që mbetën pa u privatizuar nga AKM-ja, duke krijuar kështu një vazhdimësi të punës dhe proceseve që janë kryer dikur nga AKM-ja. Siç do të shihet, AKM-ja nuk ka ndonjë autoritet në lidhje me NP-të. Autorët mendojnë se procesi i privatizimit të NSH-ve ka krijuar një përvojë të rëndësishme në këtë fushë dhe në këtë mënyrë ka kontribuar edhe në ndërtimin e kapaciteteve njerëzore që mund të angazhohen në procesin e privatizimit të NP-ve.

2.1 KORNIZA LIGJORE PËR PRIVATIZIMIN E NDËRMARRJEVE PUBLIKE

Janë dy mënyra për të transformuar një NP në pronësi private. E para: një NP mund të kalojë nëpër procesin e privatizimit tradicional, ose më mirë të themi t'iu nënshtruhet shitjes së aksioneve të NP-së një subjekti privat. Mirëpo, nga ana tjetër, një NP mund të kalojë në pronësi private përmes një partneriteti publiko-privat dhe/ose dhënies me koncesion për të ndërtuar, përdorur dhe/ose shfrytëzuar infrastrukturën në pronësi publike, si dhe për të ofruar shërbime publike. Këto dy metoda janë adresuar në mënyrë të veçantë, duke u thelluar më shumë në të parën.

2.1.1. Privatizimi

Baza ligjore për privatizimin e plotë apo të pjesshëm të një NP-je në Republikën e Kosovës mund të gjendet në Ligjin për Ndërmarrjet Publike ("Ligji për NP"). Domethënë, Ligji për NP-të bën fjalë për "shitje të aksioneve," që mund të interpretohet se ky ligj lejon privatizim të pjesshëm ose të plotë të NP-së në fjalë, varësisht nga vendimi i Qeverisë.

Shitjen e aksioneve e mundëson Ligji mbi NP-të, në veçanti neni 4, sipas të cilit brenda një kohe të caktuar të gjitha NP-të duhet të organizohet si Shoqërive Aksionare ("SHA"). Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, përkatësisht neni 126, një SHA "është një person juridik që zotërohet nga aksionarët e saj, por që legalisht është i ndarë dhe i veçuar nga aksionarët e saj. "Statusi i SHA sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare është i ngjashëm me statusin e korporatave të cilat mund t'i gjejmë në vendet anëtare të BE-së apo në Shtetet e Bashkuara, me ndryshime të vogla dhe më pak të ndërlukuara.

Aksionari i vetëm i një NP-je qendrore është Republika e Kosovës, të drejtat aksionare të së cilës ushtrohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Ligji mbi Shoqëritë Tregtare nuk e kufizon transferimin e aksioneve nga Qeveria e Republikës së Kosovës në ndonjë subjekt tjetër

Në mënyrë specifike, neni 9 i këtij Ligji rregullon privatizimin e NP-ve qendrore¹. Kështu, marrim komoditetin të konstatojmë se Ligji në fjalë nuk bën fjalë për privatizimin e NP-ve lokale, edhe pse kjo çështje nuk ka të bëjë me këtë analizë, qëllim i së cilës është analiza e kornizës ligjore për privatizimin e NP-ve qendrore.

Sipas nenit 9.1 të Ligjit mbi NP-të, procedurat për privatizimin e një NP-je qendrore janë si në vijim: 1) Qeveria miraton një vendim me shkrim me të cilin autorizohet një Komision Qeveritar për Privatizim (KQP) për të vazhduar pastaj me tenderimin dhe shitjen e aksioneve të NP-së; 2) Vendimi i Qeverisë duhet të miratohet me një shumicë të thjeshtë votash nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, dhe 3) KQP vazhdon me tenderimin dhe shitjen e aksioneve, përkatësisht me privatizim të plotë ose të pjesshëm të NP-së.

Neni 9.2 i Ligjit mbi NP-së përcakton se secili KQP do të përbëhet nga pesë anëtarë, veçanërisht 1) ministri i Ekonomisë dhe Financave, i cili është edhe kryetar i KQP-së; 2) ministri i Tregtisë dhe Industrisë; (3) ministri i Ministrisë e cila ka rolin udhëheqës në sektorin në të cilin vepron NP-ja qendrore; dhe (4) dy ministra të tjerë të emëruar nga qeveria. Qeveria është e detyruar të sigurojë që njëri nga ministrat në secilin Komision Qeveritar për Privatizim të jetë nga një komunitet jo-shumicë. Për pjesën më të madhe, KQP vepron në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe mbështetet nga një sekretariat, i cili gjithashtu është në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave².

Në bazë të këtij Ligji, tenderimi dhe shitja e aksioneve të një NP-je qendrore duhet të bëhet në një procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese, por që formati i kësaj procedure përcaktohet nga KQP. Thjesht, Ligji thekson se kjo procedurë së paku duhet të jetë në përputhje me kërkesat procedurale të Ligjit mbi Procedurat për Dhënien e Koncesioneve.

Rrjedhimisht, një KQP që është i ngarkuar me shitjen e aksioneve të NP-së duhet të zhvillojë një procedurë, e cila të paktën ndjek procedurën për dhënien e kontratave për koncesioneve nga autoritetet publike. Procedurat për koncesione të tilla janë të detajuara në nenet 5 deri 27 të Ligjit mbi Procedurën e Dhënies së Koncesioneve. Sipas këtyre neneve, ndër të tjera, 1) KQP duhet të para-seleksionojë tenderuesit të cilët mund të aplikojnë edhe si konsorciume, 2) Ofertuesit duhet t'i plotësojnë kriteret objektivisht të justifikueshme të cilat KQP i konsideron të përshtatshme në procedurë të veçantë; 3) KQP duhet të marrë një vendim të para-seleksionimit në pajtim me kriteret; 4) Ofertuesit duhet të dorëzojnë propozime, të cilat do të përfshijnë informata të caktuara; 5) KQP duhet të vendosë parametra sigurie për propozimet e ofertuesve; 6) KQP paraprakisht përcakton kriteret e vlerësimit të ofertave, të cilat duhet të jenë në përputhje me nenin 14 të Ligjit mbi Procedurën e Dhënies së Koncesioneve; dhe 7) KQP bën një zgjidhje të bazuar në ato kriteret dhe/ose të angazhohet në negociata të mëtejshme, siç janë të lejuara me këtë Ligj.

1 Në pajtim me nenin 3.1 të Ligjit mbi NP-të, NP-të qendrore janë ndërmarrjet e përcaktuara në Listën 1 që i bashkëngjitet Ligjit mbi NP-të.

2 Neni 9.3 i Ligjit mbi NP-të.

3 Për një deklaratë të hollësishme të kërkesave për dhënien e koncesioneve, dhe në këtë mënyrë duke iu referuar, për privatizimin e një NP-je nga KQP, ju lutem shih nenet 5 deri 27 të Ligjit mbi Procedurën për dhënien e Koncesioneve. Sipas nenit 9.1 të Ligjit mbi NP-të, ". . . Qeveria miraton një vendim me shkrim që autorizon një Komision Qeveritar për Privatizim të vazhdojë. . . "(Theks i shtuar), i cili mund të interpretohet për të, do të thotë se një KQP i veçantë duhet të formohet për çdo privatizimit përkatës të një NP.

Siç kemi konstatuar edhe më herët, AKP-ja është eliminuar nga procedura e privatizimit të NP-ve, pa marrë parasysh përvojën e saj në privatizimin e ndërmarrjeve të mëdha. Privatizimi i NP-ve është transferuar kështu te Qeveria, duke i dhënë kompetencat të ndjeshme Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Çfarë është pozitive, duket se Ligji mbi NP-të lejon formimin e KQP përkatëse për privatizimin e çdo NP-je. Prandaj, privatizimi i çdo NP-je do të ketë KQP-në e vet.

2.1.2. Partneriteti publiko-privat dhe koncesionet

Partneriteti publiko-privat është një tjetër mënyrë për të pasur një NP të privatizuar për një kohë të caktuar edhe këtë duke e dhënë atë në koncesion. Procedurat dhe çështjet e tjera për partneritetin publiko-privat rregullohen me Ligjin mbi Partneritetin Publiko-Privat ("Ligji PPP"). Qëllimi i Ligjit të PPP-së është të caktojë kornizën ligjore për dhënien e partneritet publik-privat dhe të koncesioneve për të ndërtuar, përdorur dhe/ose shfrytëzuar infrastrukturën në pronësi publike dhe për të ofruar shërbime publike. Veçanërisht, Ligji mbi PPP "rregullon të drejtat për të shfrytëzuar dhe/ose shfrytëzuar infrastrukturën në pronësi publike dhe/ose për të ofruar shërbime publike në të gjithë sektorët ekonomikë dhe shoqërorë."³

Siç parashikohet nga neni 2, Ligji mbi PPP zbatohet për një gamë të gjerë fushash duke përfshirë, por jo kufizuar, atë të transportit, energjisë, ngrohjes, ujit, telekomunikacionit, arsimit, shëndetësisë, dhe shumë fusha të tjera. Rrjedhimisht, marrëveshjet mund të jenë bërë midis Republikës së Kosovës dhe një subjekti privat për të hyrë në një partneritet në lidhje me marrjen në pronësi dhe menaxhim të një etniteti të caktuar publiko-privat, apo në mënyrë më të thjeshtë dhënia në tërësi e këtij entiteti me koncesion një personi privat, dhe çdonjëra deri në 45 vjet⁴.

Procesi për realizimin e një PPP ose dhënia e një NP-je me koncesion për një palë private është përcaktuar në mënyrë strikte të jetë nën autoritetin e qeverisë. Sipas nenit 6.1 të Ligjit mbi PPP, PPP-të dhe koncesionet "do të jepen nga Autoriteti Publik i cili, në bazë të ligjit, është drejtpërdrejt përgjegjës për aktivitet ekonomik, i cili është objekt i marrëveshjes." Megjithatë, me miratimin paraprak të Qeverisë, partneritetet publike private ndër-ministore, Komiteti Drejtues Ndërmarrës për Partneritet Publiko Privat (PPP-KNM) ka autoritet "për të vepruar si një Autoriteti Kontraktues dhe të japë me koncesion dhe të drejta të tjera për të ndërtuar PPP, përdorur dhe/ose të shfrytëzuar një lehtësi të infrastrukturës publike." PPP KNM është themeluar për të kontrolluar dhe të koordinuar projektet e PPP-ve në të gjithë sektorët ekonomikë dhe shoqërorë, i cili kryesohet nga ministri i Ekonomisë dhe Financave, i cili gjithashtu drejton dhe koordinon aktivitetet e PPP-KNM⁵.

3 Neni 2 i Ligjit mbi PPP.

4 Nenin 8 i Ligjit mbi PPP. Argumentet janë në favor të asaj që periudha dyzetvjeçare duhet të reduktohet në njëzet e pesëvjeçare për shkak se njëzet e pesë vjet janë të mjaftueshme për një subjekt privat për të marrë një kthim të shëndoshë të investimit. Kjo qasje do shmangur ekspozimin e Republikës së Kosovës për humbjet që rrjedhin nga marrëveshjet më të gjata pa pasur mundësi që të rivlerësojë pozitën e saj. Shih prill 15 2009 letër dërguar kryetarit të Kuvendit, z. Jakup Krasniqi, nga prof Muhamet Mustafa dhe z. Luan Shllaku (në emër të Forumit 2015).

5 Neni 11 i Ligjit mbi PPP.

KNM PPP-është një trup i fuqishëm me lidhje të PPP-ve dhe dhënien e koncesionit. Në të vërtetë, ky trup është autoritet vendimmarrës në këtë drejtim⁶. Në bazë të nenit 12 të Ligjit mbi PPP, KNM-PPP siguron lidhshëm në zhvillimin e politikave dhe të programeve të PPP-ve, dhe bërjen e rekomandimeve Qeverisë për shqyrtim dhe miratim. Për më tepër, ky trup ndër të tjera, gjithashtu drejton programin kombëtar të PPP, zhvillon politikën, zbaton pjesët e rregullore në lidhje me rregullat dhe standardet për projektet e PPP-ve dhe dokumenteve të projektit, shqyrton dhe miraton/nuk i miraton projektet propozimet mbi bazën e përfitimit sipas value-for-money dhe konsiderata të tjera, vepron si Autoritet Kontraktues në projekte të veçanta, etj. Sikurse KQP-ja, edhe KNM-PPP mbështetet nga një sekretariat në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, në përputhje me nenin 13 të Ligjit mbi PPP.

Roli i Kuvendit në PPP dhe procedurat për koncesionet është jo ekzistent. Megjithatë, Kuvendi merr një raport vjetor mbi koncesionet dhe PPP. Në përputhje me nenin 2,6 të Ligjit mbi PPP, Qeveria përmes Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, si përfaqësues i KNM-PPP, përgatit një raport vjetor mbi koncesionet dhe PPP dhe e paraqet atë në Kuvend.

Thënë më thjeshtë, partneriteti publiko-privat dhe koncesionet janë një metodë për privatizim të pjesshëm apo të plotë të një NP-je të kufizuar në pikëpamje kohore. Vendimet në këtë drejtim merren nga autoriteti publik përgjegjës ose, nëse në rast se është zgjedh, këto vendime i merr KNM-PPP-ISC. Se çfarë qasje Qeveria do të ketë në privatizimin e një NP-je varet nga shumë faktorë, duke përfshirë, por jo kufizuar, faktorët ekonomikë, socialë dhe politikë.

2.2 ANALIZA E KORNIZËS LIGJORE NË LIDHJE ME PRIVATIZIMIN

Tani, procesi i privatizimit të NP-ve ka filluar me miratimin e Ligjit mbi NP-të dhe Ligjit mbi PPP. Janë evidente shumë përfitime nga fakti se janë miratuar këto dy ligje, sepse ato japin elementet themelore të nevojshme për të filluar procesin e privatizimit për NP-të. Ligji mbi PPP është veçanërisht i përshtatshëm dhe i hartuar mirë, pavarësisht se i jep shumë fuqi Qeverisë, veçanërisht ministrit të Ekonomisë dhe Financave si kryetar i KNM-PPP. Pavarësisht mosbalancimit të pushtetit, Ligji mbi PPP ofron një bazë të mirë për fillimin e partneritetit publik-privat-ose dhënien e koncesioneve. Në fakt, shumica e defekteve ligjore vijnë nga Ligji mbi NP-të, dispozitat e të cilit merret me privatizimin e NP-ve në kuptimin tradicional, gjë që lejon mundësi të dëmtojnë procesin e privatizimit të NP-ve.

Duke filluar me aspektet pozitive të Ligjit mbi NP-të, është e nevojshme të përgatitet baza ligjore për transferim të pronësisë së NP-së nga Qeveria e Republikës

⁶ Qeverisa bëhet një vendimmarrëse në lidhje me këtë në qoftë se ka një konflikt juridik mes autoriteteve të ndryshme publike. Një konflikt i tillë ekziston me koncesion e Aeroportit të Prishtinës, ku autoriteti publik mund të jenë Ministria e Postës dhe Telekomunikacionit, Ministria e Punëve të Brendshme, ose Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

së Kosovës, të cilat deri më tash ose nuk kanë treguar performancë të mjaftueshme ose nuk e kanë mbërri potencialin e tyre të plotë. Korniza aktuale ligjore i jep të drejtë Qeverisë që të vendosë për fillimin e procesit për transferimin e NP-ve në pronësi private. Me kusht që të zbatohen në mënyrë adekuate, këto ligje kanë një potencial për të kryer me sukses privatizimin e NP-ve.

Nga ana tjetër, ka disa mangësi që potencialisht mund të dëmtojnë procesin e privatizimit të NP-ve. Së pari, privatizimi i NP-ve është hequr krejtësisht nga AKP-ja, mekanizëm ky që tashmë ka përvojë të konsiderueshme për sa i përket privatizimit. Neni 9 i Ligjit mbi NP-të, vendos tërë procesin e privatizimit në duart e Qeverisë dhe parashikon formimin e KQP-ve individuale për privatizimin e çdo NP-je, dhe të një sekretariati në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për të mbështetur punën e KQP-së. Me fjalë të tjera, neni 9 kërkon formimin e një AKP-je të re (sekretariat), në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, për të menaxhuar në mënyrë specifike privatizimin e NP-ve.

Së dyti, Ligji mbi NP-të nuk mundëson marrjen e vendimeve nga ndonjë organ profesional (AKP) duke ia atribuuar këtë të drejtë KQP-së, i cili është një entitet politik, i përbërë tërësisht prej anëtarëve të Qeverisë, përkatësisht ministrave. Kjo mund të dëmtojë procesin e privatizimit të NP-ve dhe këtë proces ta bëjë të ndjeshëm ndaj ndikimit politik dhe parregullsive. Prosesi në fakt kryesisht është lënë në duar të Qeverisë, me përjashtim të detyrimit ligjor për një miratim paraprak të vendimit nëse do të nisë privatizimi i një NP-je ose jo, me një shumicë të thjeshtë votash në Kuvend, por pa ndonjë mbikëqyrje të procesit në vazhdim. Nuk ka udhëzime se çfarë duhet të jetë përfshirë në propozimin e Qeverisë për privatizimin e një NP-je, i cili i dërgohet Kuvendit për votim. Nuk ka ndonjë udhëzim se çfarë lloj vendimi Kuvendi duhet të marrë, thjesht të sigurojë një 'po' ose 'jo', ose të gjurmtojë më thellë për të determinuar çështjet që kanë të bëjnë me privatizimin e NP-ve të caktuara, të tilla si politikat dhe strategjitë për privatizimin e së njëjtës NP.

Prandaj Kuvendi është mënjanuar nga çdo debat mbi çështjen dhe shërben thjesht për t'i vënë vulë vendimit të marrë nga Qeveria, përkatësisht KQP. Duke pasur parasysh faktin se anëtarët e Kuvendit janë të vetmit të zgjedhur nga qytetarët e Kosovës, heqja e Kuvendit nga ky proces praktikisht eliminon nga procesi të vetmit persona që janë drejtpërdrejt përgjegjës para atyre që supozohet të jenë përfitues nga privatizimi i NP-ve, përkatësisht qytetarët e Kosovës. Kështu, një amendament i këtij ligji është i domosdoshëm në mënyrë që roli i Kuvendit të jetë më i gjerë në lidhje me marrjen e vendimit nëse do të privatizojë (ose të shesë aksionet) e një NP-je, por edhe në lidhje me të ardhurat, ku duhet të shkojnë, me çfarë përqindje duhet të privatizohet një NP, etj.

Në të njëjtën mënyrë, në lidhje me PPP dhe koncesionet, Kuvendi është larguar edhe më tej nga procesi, por duke mbajtur në njëfarë mënyre afër këtyre proceseve vetëm përmes një raporti vjetor, i cili i paraqitet Kuvendit nga Qeveria, përmes ministrit të Ekonomisë dhe Financave si kryesues i KNM-PPP. Përderisa përfshirja e Kuvendit në çdo PPP dhe/ose kontratë koncesioni nuk do të jetë efikase, do të ishte e nevojshme të sigurojmë përfshirjen e tij deri në një nivel të përshtatshëm në fushat që thellësisht e afektojnë Kosovën dhe popullin e saj. Për më tepër, Kuvendi nuk është në atë pozitë që të monitorojë siç duhet procesin e privatizimit të NP-ve. Kuvendi më nuk është në gjendje të monitorojë si duhet procesin e privatizimit të

NP-ve. Raportimi i Qeverisë në Kuvend dhe mënyra e raportimit lidhur me këto çështje nuk është e qartë dhe e përcaktuar mirë.

Së treti, në përcaktimin e procedurave lidhur me atë se si do të zhvillohet privatizimi i NP-ve, Ligji mbi NP-të i referohet Ligjit mbi Procedurën e Dhënies së Koncesioneve si standarde minimale, pa dhënë ndonjë detaj shtesë. Hartimi i këtyre procedurave të rëndësishme është deleguar poshtë te KQP. Si rezultat, kjo lejon hapësirë për mospërputhje eventuale midis procedurave në privatizimin e NP-ve të ndryshme, sepse KQP-të individuale duhet to formohen për privatizimin e çdo NP-je. Më tej, mos vendosja paraprake e parametrave, privatizimi i një NP-je potencialisht mund të bëhet në një mënyrë të papërshtatshme, duke rrezikuar kërkesën për riprivatizim, gjë që do të zvogëlonte besimin e investitorëve dhe do të shkaktonte kosto shtesë. Në lidhje me PPP dhe koncesionet, procedurat janë të parapërcaktuara me Ligjin mbi PPP dhe Ligjin mbi Procedurat e Dhënies së Koncesioneve.

Së katërti, duke nënkuptuar me kohë specifikat individuale të NP-ve, shumë vende të tjera kanë miratuar ligje të veçanta për t'u marrë me privatizimin e secilës NP, siç ka qenë rasti në Shqipëri. Me ekzistimin e vetëm një ligji, në të vërtetë vetëm neni, që rregullon çështjen e privatizimit të NP-ve, legjislatura ka injoruar adresimin e vëmendjes te secila NP. Si në shumë vende të tjera, privatizimi i kompanive të mëdha dhe të rëndësishme duhet të bëhet në bazë të legjislacionit të veçantë për çdo sektor apo kompani të veçantë. Miratimi i ligjeve të veçanta merr parasysh që një propozim të debatohet jo vetëm në Kuvend por edhe më gjerë në shoqëri me grupe profesionale, akademikë, studiues dhe media.

Së pesti, as Ligji mbi NP-të dhe as Ligji mbi PPP-të nuk japin udhëzime në lidhje me atë se si të ardhurat nga privatizimi apo PPP / koncesion e një NP-je duhet të ndahen ose të shpenzohen. Ligji mbi NP-të nuk përmend asgjë as në lidhje me këtë çështje. Nga ana tjetër, Ligji mbi PPP-të siguron liri të mjaftueshme për KNM-PPP që, përveç tjerash, të menaxhojë Programin Kombëtar të PPP dhe të zhvillojë politika të përgjithshme të PPP-ve, e që mund të interpretohet që në këtë mënyrë i lejohet këtij organi të marrë edhe vendime lidhur me këto çështje.

Dhe së fundi, procesi i privatizimit të NSH-ve ka ulur ndjeshëm besimin e investitorëve, ngase ai u përcoll me akuzat për korrupsion dhe konflikt interesash. Mungesa e zbatimit të ligjeve kundër korrupsionit, mos marrja e masave për të ndaluar këto dukuri, e ka afektuar procesin e privatizimit të NSH-ve dhe, nëse e njëjta gjendje vazhdon të jetë e pranishme, do të ndikojë negativisht edhe në procesin e privatizimit të NP-ve. Kështu, në qoftë se dëshirohet të tërhiqen investitorët, autoritetet duhet të reflektojnë më me vendosmëri në luftën kundër korrupsionit dhe eliminimin e konfliktit të interesit. Për më tepër, roli i Kuvendit në privatizim duhet të ngrihet në mënyrë që të sigurojë transparencë të mjaftueshme dhe debat profesional.

3.1 PRIVATIZIMI DHE KONCESIONIMI I KOMPANIVE STRATEGJIKE NË EKONOMITË E TRANZICIONIT

Në dy dekadat e fundit, shumë vende anë e kënd botës (të zhvilluara, në zhvillim apo vende në tranzicion) kanë iniciuar reforma në industrinë e shërbimeve publike me qëllim që të përmirësojnë eficiencën e këtyre ndërmarrjeve përmes konkurrencës dhe pronësisë private (Lieberman, 2008). Reforma në shërbime publike i referohet, dhe përfshin, një numër të madh masash që fillojnë nga ndarja vertikale e disa aktiviteteve të këtyre ndërmarrjeve, futja e konkurrencës në nivele të ndryshme të operimit dhe privatizimin e pjesëve të ndryshme të shërbimeve publike dhe zakonisht pronarëve të ndryshëm. Tradicionalisht, karakteristikat⁷ e "monopoleve natyrore" dhe veçoritë e shërbimeve publike të këtyre ndërmarrjeve bënë që ato të trajtohen ndryshe nga NSH-të e tjera. Në shumicën e ekonomive në tranzicion privatizimi i këtyre industrive që klasifikoheshin si "industri strategjike", u zhvillua më vonë dhe në mënyrë më të ngadalshme sesa privatizimi i ndërmarrjeve të tjera. Për më tepër, privatizimi i shërbimeve publike krijoi nevojën e ndërtimit të kornizave rregullative që do të mbronin konsumatorin nga shpërdorimi i pozitës monopoliste nga ndërmarrjet private, si dhe do të mbronin ndërmarrjet private nga eksproprijimet nga shteti (Megginson, 2005). Në këtë seksion ne së pari do të prezantojmë disa veçori të privatizimit përmes koncesionit (3.1) para se të vazhdojmë tutje të trajtojmë përvojat e ekonomive në tranzicion në privatizimin e sektorit të telekomunikimeve (3.2.1) dhe në Kosovë (3.2.2) pastaj privatizimin e sektorit të energjisë në ekonomitë e tranzicionit (3.3.1) dhe Kosovë (3.3.2) dhe koncesionimet e aeroportëve në ekonomitë e tranzicionit (3.4.1) dhe në Kosovë (3.4.2). Mësimet e nxjerra nga reformimi i këtyre segmenteve vlejné edhe për shërbimet e tjera publike.

3.1 Privatizimi i infrastrukturës përmes koncesioneve⁸

Ristrukturimi dhe privatizimi i shërbimeve infrastrukturore (gjenerimi i rrymës, ujësjellësi, rrugët, aeroportet, portet etj.), apo përfshirja e sektorit privat në ofrimin e këtyre shërbimeve, tani përgjithësisht pranohet të jetë superior ndaj pronësisë publike dhe ofrimit të këtyre shërbimeve nga ndërmarrjet publike. Me kalimin e kohës, është bërë më se e qartë se ndërmarrjet në pronësi shtetërore që ofrojnë shërbime publike nuk janë në gjendje që të përdorin burimet e tyre në mënyrë efektive dhe të ofrojnë shërbime të kualitetit të lartë. Ato nganjëherë janë dhe barrë e madhe fiskale (me gjithë pozitën e tyre monopoliste) dhe zakonisht kanë nevojë për shuma të mëdha parash që të përmirësojnë pozitën e tyre. Veçoria kryesore e politikave ekonomike në vendet e zhvilluara, atyre në zhvillim dhe vendeve në

7 Në shumë vende, është besuar se shërbimet publike kanë veçori të monopoleve natyrore por zhvillimet në teorinë ekonomike dhe risitë teknologjike të dy apo tri dekadave të fundit (në veçanti në telefoninë mobile, teknologjinë digjitale, gjeneratorëve të vegjël dhe eficient të rrymës etj.) kanë dëshmuar se vetëm një pjesë e vogël e veprimeve të shërbimeve publike (siç është transmissioni) kanë veçori të monopolist natyrorë e jo prodhimi dhe shitja.

8 Termet si 'lizing', 'franshizë' or 'afferimage', të përdorura në literaturën e privatizimit i referohen koncepti të njëjtë të 'koncesionimit'.

tranzicion, është që shërbimet publike dhe projektet e tjera infrastrukturore duhet të shturen (ristrukturimi dhe ndarja vertikale) dhe eventualisht të privatizohen në mënyrë që të përmirësojnë eficiencën, kualitetin e shërbimit dhe mirëqenien e konsumatorit. Në disa raste, posaçërisht në vendet më pak të zhvilluara, infrastruktura ekzistuese e këtyre shërbimeve është më pak e zhvilluar dhe ekziston dyshim real nëse investitori privat shfaq interes në privatizimin e këtyre ndërmarrjeve. Shteti në anën tjetër mund të jetë në situatë kur nuk mund t'i përdorë burimet e tij të kufizuara për t'i rehabilituar këto ndërmarrje⁹. Në këto raste, "rruga e koncesionimit" paraqet një mundësi tërheqëse për të përfshirë sektorin privat dhe të përfitojë nga përfshirja e këtij sektori: sektori privat do të përdorë burimet e veta financiare, teknike dhe menaxhuese për të ndërtuar dhe shfrytëzuar infrastrukturën e këtyre shërbimeve për një periudhë të caktuar, e cila siguron një kthim të arsyeshëm të investimeve të bëra.

Koncesionet janë bërë një mënyrë e përhapur e tërheqjes dhe shfrytëzimit të kapitalit privat për projekte infrastrukturore në vitet e 80-a, fillimisht në Amerikën Latine dhe shtetet e Karaiibeve dhe në shumë vende në mbarë botën – gjatë kësaj periudhe janë bërë rreth 2500 koncesione¹⁰. Në fakt ndërmjet viteve 1990 dhe 2000, koncesionimi ka qenë mënyrë më e përhapur sesa privatizimi i menjëherëshëm. Gjatë kësaj periudhe, nga 849 projekte të përfshirjes së sektorit privat, 65% janë realizuar përmes marrëveshjeve koncesionare. Proporcioni ishte shumë më i madh në fusha të caktuara si në aktivitetet e transportit (98% e të gjitha projekteve në këtë sektor), ujësjellës dhe kanalizim (89%), energjetikë (54%) dhe shumë më pak ka në sektorët si telekomunikimet (vetëm 3%)¹¹.

Koncesioni nënkupton dhënien e të drejtës ekskluzive investitorit privat që të operojë me ndërmarrjen publike dhe të përfitojë nga ajo për një periudhë të caktuar kohore në këmbim të "obligimit për të investuar" dhe "kualitetit të shërbimeve që ofron". Nganjëherë, pritet që koncesionari të ndërtojë një projekt nga fillimi apo t'i rindërtojë dhe modernizojë objektet ekzistuese dhe t'i shfrytëzojë ato për një periudhë të caktuar para se ato të transferohen prapë në pronësi shtetërore (ndërto, opero dhe transfero apo siç njihen ndryshe projekte BOT). Në rastet e tjera koncesionari e ndërton projektin nga fillimi, e mban atë në pronësi dhe operon me të përmes licencës nga Qeveria (projektet e njohura si ndërto, posedo dhe opero apo siç njihen ndryshe projekte BOO). Për ri-licencim duhet të aplikohet në fund të periudhës së koncesionit.

Si funksionojnë koncesionet? Koncesioni qeveriset nga një kontratë afatgjatë ndërmjet shtetit (apo agjenci shtetërore apo ministri) dhe koncesionari në bazë të së cilës ky i fundit, operon në mënyrë ekskluzive me infrastrukturën e ndërmarrjes publike për një periudhë të caktuar kohore (e cila periudhë mund të rinovohet), bën investimet e nevojshme që të sigurojë ofrimin e shërbimeve me cilësi të duhur (të akorduar) në kontratë, të bëjë furnizimin me lëndë të parë me çmime të arsyeshme dhe të shesë produktin/shërbimin (apo një pjesë të tij) me çmime të arsyeshme që i nënshtrohen procesit rregullator bazuar në mekanizmin e normës së kthimit apo çmimit tavan që të sigurojë një kthim të ndershëm nga investimi. Kontrata mund të

9 Koncesionet janë tërheqëse në mënyrë të veçantë në vendet ku për shkaqe politike, disa aktivitete edhe në mënyrë formale mbesin në pronësi shtetërore apo ku kushtetuta ndalon transferimin e tyre në pronë private. Normalisht, ky nuk është rasti i Kosovës.

10 Harris (2002)

11 Shih Guasch (2004), f. 25.

përcaktojë që koncesionari të kompensohet për pjesën e investimit që nuk amortizohet në fund të periudhës (në mënyrë që të shmangë nën-investimet). Në fund të afatit të kontratës, objektet i kthehen shtetit (apo agjencisë) i cili mund të kërkojë ndonjë koncesionar tjetër për të zhvilluar dhe operuar këtë sektor.

Kriteret për ofertim. Marrëveshja e koncesionit krijon kriteret e ofertimit të cilat mund të ndryshojnë në aktivitete të ndryshme: mund të jetë 'pagesë për transferim', 'taksë mesatare' apo 'zvogëlim në subvencion' – së bashku me obligimin për të investuar dhe kualitetit të shërbimit që duhet ofruar. Nëse ndërmarrja është fitimprurëse, atëherë kriter mbetet shuma më e lartë e transferit (pagesës vjetore që koncesionari i paguan qeverisë). Nëse ndërmarrja krijon humbje, kriter do të jetë se kush merret vesh që të operojë ndërmarrjen me sa më pak subvencionim apo ofron tarifat më të vogla. Në disa raste aplikohet një kombinim i këtyre kriterëve. Procedura e seleksionimit është e komplikuar nga fakti se ofertuesit jo vetëm se duhet të bëjnë ofertë për kritere specifike, por gjithashtu duhet të bëjnë një ofertë financiare. Kushtet e koncesionimit duhet të përcaktojnë qartë vlerën e secilit kriter të përfshirë në ofertë.

Koncesionimi dhe konkurrenca. Edhe pse dhënia e së drejtës ekskluzive për të operuar me ndërmarrjen publike nuk është në pajtueshmëri me konkurrencën, prapëseprapë është e mundur që të krijohet rezultat konkurrues nëse koncesionari zgjedhjet përmes procesit konkurrues: përderisa është e pamundur që të kemi "konkurrencë në treg" për këta sektorë, si rrugët, aeroportet, hekurudhat etj., është e mundur që të kemi 'konkurrencë për t'u futurë në treg' dhe e njëjta mund të sigurojë se rezultati është i ngjashëm me atë të tregut konkurrues (të kontestueshëm). Kjo arrihet duke zgjedhur koncesionarin përmes konkurrimit ku kompanitë konkurrojnë ndërmjet vete për të drejtën për të operuar ndërmarrjen përmes ofrimit të çmimit më të mirë, investimeve më të larta apo kualitetit më të mirë (apo një kombinim i tyre)¹². Në të vërtetë, koncesioni i suksesshëm përfshin fazën e parakualifikimit ku fillimisht në bazë të numrit të kushteve dhe kriterëve zgjidhet një numër i caktuar i ofertuesve përderisa eliminohen ofertat jo-serioze. Ofertuesit e zgjedhur më pas duhet të ofrojnë ofertat e detajuara mbi nivelin e investimeve, kualitetin dhe çmimet¹³.

Ofertimi (dhe ri-ofertimi) konkurrues është elementi thelbësor për të siguruar koncesion efikas; nëse, për çfarëdo arsye, disa nga kompanitë nga lista e ngushtë

12 Në punimin e tij 'Përse të rregullohen shërbimet publike', Harold Demsetz (1967) sugjeron që mallrat dhe shërbimet që kanë veçori të monopolit natyror mund të prodhohen duke ofruar franshizë operatorëve privat që zgjedhën përmes tenderit konkurrues. Në procesin e tenderimit, konkurrentët zotohen se do të ofrojnë mallra dhe shërbime me çmime konkurruese dhe nëse ky proces përsëritet vazhdimisht në disa vite, operatorët do të jenë të nxitur të respektojnë marrëveshjen kur të kenë marrë të drejtën të ofrojnë atë produkt apo shërbim.

13 Shih Newbery (2000) për diskutim të detajuar të fazave të ndryshme të zbatimit të marrëveshjes së koncesionit.

tërhiqen nga ofertimi, ekziston rreziku serioz se ofertuesit e mbetur do ta keqpër dorin këtë situatë duke nxjerrë koncesione që janë të pafavorshme për Qeverinë¹⁴. Për koncesionet që janë për periudha afatgjata, ri-ofertimi është esencjal posaçërisht në përpjekje për të shmangur kapjen e rregullatorëve (për shembull në sektorin e energjisë në Argjentinë, koncesioni është për 95 vjet por ekziston riefertimi pas 15 vjetëve dhe më pas në çdo 10 vjet). Riefertimi është i domosdoshëm edhe për skemat BOO (ndërto-posedo dhe opero) ku ndërmarrja private ka pronësi mbi asetet. Kompanitë kanë nevojë për t'u licencuar që të operojnë (siç është rasti i Aeroportit) dhe duhet të konkurrojnë për të çdo 10-12 vjet që të sigurohet se nuk operon si monopolist. Nëse licenca i revokohet dhe i ofrohet një kompanie tjetër përmes ofertimit konkurrues, atëherë kompania fillestare kompensohet në mënyrë të ndershme.

Cilat janë parakushtet për koncesionim? Në mënyrë që koncesioni të funksionojë, ai duhet të paraprihet me ristrukturimin dhe shthurjen e ndërmarrjeve të integruara publike (që të ketë njësi të definuara mirë dhe teknikisht të pavarura) dhe të krijojë rregullator të pavarur. Përvoja e vendeve ish-socialiste dhe të atyre me ekonomi të tregut ka treguar se reformat mikroekonomike (për çdo kompani, apo shërbim të caktuar publik) duhet të fillojnë me ristrukturim: shthurje dhe ndarje vertikale të ndërmarrjeve të integruara dhe krijimin e kushteve për të ndryshuar sistemin e stimujve dhe rrjedhimisht sjelljen e tyre. Në anën tjetër, e drejta ekskluzive për të operuar me ndërmarrjen përgjatë kohëzgjatjes së koncesionit i jep koncesionarit pozitë monopoliste. Në shumicën e rasteve, këto ndërmarrje kanë veçori të monopoleve natyrore gjë që e bën konkurrencën (në kuptim të disa operatorëve duke konkurruar me njëri-tjetrin) të padëshiruar apo jopraktike. Kjo kushtëzon krijimin e një rregullatori të pavarur i cili siguron se koncesionari u përmbahet obligimeve për investime dhe cilësi dhe gjithashtu ka fitime të arsyeshme (me mekanizma të mjaftueshme që inkurajojnë eficiencën).

Proces rregullator. Duke pasur parasysh natyrën monopoliste të koncesionit, dhe dhënien e së drejtës ekskluzive koncesionarit, është esenciale që të dizajnohet një proces i përshtatshëm rregullator për koncesionin. Rregullimi mund të ketë formën e 'rregullimit të normës së kthimit' apo 'rregullimit të çmimit'¹⁵. Në disa raste koncesionari duhet të blejë lëndën e parë nga një monopolist tjetër, (zakonisht nga shteti). Kushtet e kontratës duhet të specifikojnë metodologjinë se si çmimet e lëndës së parë janë të fiksuara apo ndryshojnë (që të krijojë siguri për koncesionarin). Për shembull në Shqipëri Marrëveshja e koncesionit me kompaninë e shpërndarjes përcakton që ndërmarrja shtetërore e gjenerimit të energjisë elektrike ta ketë të rregulluar normën e kthimit në maksimum 4%.

14 Në disa raste, posaçërisht kur ka pak interes nga ana e investitorëve privat për të marrë pjesë në projekte infrastrukturore, negociatat e drejtpërdrejta ndërmjet qeverisë dhe investitorit (ve) potencial mund të zëvendësojnë tenderimin konkurrues. Megjithatë, tenderimi konkurrues parapëlqehet para negociatave të drejtpërdrejta, kjo e fundit është e pashmangshme në disa raste. Në këto raste, qeveria duhet të rritë transparencën që të siguroj se kontrata është dizajnuar mirë.

15 E para krijon një normë të arsyeshme të kthimit dhe lejon ndërmarrjen që të caktojë çmimin që nxjerr atë normë kthimi. Ky proces rishikohet në mënyrë periodike (3-5 vjet). E dyta lejon firmën që të rrisë tarifën e veta në bazë të inflacionit minus faktorin e eficiencës (që të ndajë me konsumatorin përfitimet nga eficiencia). Kjo zakonisht referohet si "RPI-X", ku vlera e X caktohet nga rregullatori çdo 3-5 vjet.

Duke pasur parasysh përparësitë e rregullimit përmes çmimit tavan, e njëjta ka qenë metoda më e përhapur e rregullimit të koncesioneve të mëparshme, përderisa rregullimi përmes normës së kthimit është përdorur në shumë më pak raste. Në shumë raste, ka pasur një kombinim të dy modeleve – çmimi tavan duke lejuar shumë kalime automatike¹⁶.

Problemi 'Hold-up' dhe sjellja oportuniste. Problemi kryesor në operimin e koncesionit është problemi 'hold-up' dhe sjellja oportuniste. Pasi që kontratat e koncesionit janë afatgjata dhe u nënshtrohen pasigurive të ndryshme, është shumë e vështirë që të parashihen të gjitha problemet që mund të dalin dhe rrezikojnë marrëdhënien ndërmjet qeverisë dhe koncesionarit. Kontrata, për nga natyra, do të jetë "e pakompletuar" dhe lë hapësirë që të dyja palët të përfshihen në sjellje oportuniste, duke tentuar që të ri-negociojnë kushtet e kontratës në favor të tyre. Në njërën anë, tregu shërbehet nga një ndërmarrje e dominuese, e cila është në pozitë që të ushtrojë presion ndaj Qeverisë duke zvogëluar prodhimin (hold-up), me pretekstin se ndryshimi i kushteve kërkon ndryshim të dispozitave të kontratës. Në anën tjetër, Qeveria (posaçërisht në periudha para dhe pas zgjedhjeve) mund të akuzojë ndërmarrjen publike dhe Qeverinë e kaluar, që fillimisht ka nënshkruar koncesionin, për operim të keq dhe si rrjedhojë të kërkojë ri-negocimin e kushteve të kontratës. Qeveria mund të mendojë se pasi që investitori ka shpenzuar shumë para në fillim (sunk cost), ai nuk do të largohet nga tregu dhe në këtë mënyrë mund të jetë nën trysni. Marrëveshja efikase e koncesionit do të ofronte mundësi të rishikimit periodik të pikave specifike që mund të jenë subjekt i rishqyrtimit. Në të kundërtën, përgjithësisht, ri-negocimi i kontratës duhet të kundërshtohet.

Koncesionimi dhe privatizimi i drejtpërdrejtë. Përderisa qëllimi i të dy metodave është i njëjtë (efiçencë më e lartë përmes angazhimit të sektorit privat dhe njohurisë dhe ekspertizës së tyre teknike dhe menaxheriale), ekzistojnë dallime në funksionimin e tyre. Në rastet e koncesionimit, Qeveria mban në pronësi tokën dhe asetet e ndërmarrjeve dhe mbetet e angazhuar me këto shërbime përmes monitorimit të zbatimit të kontratës, kontrollimit të tarifave, cilësisë së shërbimit dhe ri-negocimit të mundshëm. Përgjegjësia për investime dhe për rreziqe të ndryshme (risku i punës, risku i të ardhurave, risku i shpenzimeve dhe risku menaxherial) merren nga koncesionari. Në rastet e privatizimit, pronësia e aseteve dhe përgjegjësia e menaxhimit të tyre i bijnë plotësisht pronarit privat.

A ka kohëzgjatje optimale për koncesione? Koncesionari që ndërmerr një investim të shkallës së gjerë në infrastrukturë pret të marrë kthim të arsyeshëm nga investimi i bërë. Kohëzgjatja e koncesionit duhet të jetë aq e gjatë sa të ofrojë nxitje të mjaftueshme që koncesionari të bëjë investimet e kërkuara, të nxjerrë investimet e bëra si dhe të realizojë një fitim të arsyeshëm. Nëse periudha e kontratës është shumë e shkurtër, atëherë nuk ka nxitje të madhe për të investuar. Nëse periudha është shumë e gjatë, atëherë ka rrezik se firma pozicionohet (lëshon rrënjë) (duke qenë ndërmarrja e vetme ajo fillon të operojë si monopolist) dhe vë nën kontroll institucionet kyçe (ndërmarrja e cila operon e vetme për një kohë të gjatë krijon raport të ngushta me agjencitë qeveritare dhe siguron se politika dizajnohet për t'u shërbyer interesave të saj). Zakonisht koncesionet janë 15 deri në 20 vjet,

¹⁶ Një studim i koncesioneve në Amerikën Latine dhe shtetet e Karaiibeve tregon se nga 895 koncesione, ndërmjet viteve të 80-a dhe vitit 2000, çmimi tavan është përdorur në 56% të rasteve, norma e kthimit në 20% të rasteve dhe metoda të përziera në 24%. Për detaje, shih Guasch, et al. (2004), f. 15.

megjithëse ekzistojnë edhe koncesione për periudha më të gjata. Për shembull, ka koncesione për 30-50 vjet për Hekurudha në Argjentinë, Brazil apo Meksikë dhe koncesion 95 vjet në sektorin e energjisë në Argjentinë (megjithëse e kjo e fundit përfshin ri-tenderimit pas 15 vjetëve dhe më vonë pas çdo 10 vjetëve)¹⁷. Natyrisht, mund të mos jetë në gjendje apo mund të mos dëshirojë që të kompensojë të gjitha investimet e veta në fund të periudhës së koncesionimit. Përveç investimeve të ndërmarrjes në infrastrukturë, operatori privat gjithashtu rrit vlerën e afarizmit të vet duke krijuar ekspertizë dhe reputacion dhe duke zhvilluar kapitalin e vet njerëzor. Për më tepër, duke pasur parasysh se projektet e mëdha kërkojnë investime të vazhdueshme, nuk do të ishte e mundshme (apo fitimprurëse as për kompaninë por as për Qeverinë) që të lejojë amortizimin e plotë të gjithë investimit. Në mënyrë që të sigurohet se investitori do t'u përmbahet obligimeve të veta dhe praktikave të mira deri në fund të periudhës së koncesionit, kontrata duhet të ofrojë kompensim për investitorin në fund të periudhës së koncesionit për asetet e pa amortizuara, njohuritë (know-how), dhe reputacionin.

Të metat e koncesionit. Pasi që nuk mund të parashihen të gjitha rrethanat në të ardhmen, disa vendime janë subjekt i negociatave të mëtutjeshme, duke lënë hapësirë për pazarllëk, korrupsion dhe trysni nga pala me pozicion më të fortë etj., që rezulton me efekte joeficiente. Qeveria (posaçërisht Qeveritë e sapozgjedhura) mund të vihet nën trysni nga operatorët ekzistues (të cilët kanë përvojë në operimin e këtyre ndërmarrjeve dhe kanë informacione më të detajuara se Qeveria) për të filluar ri-negocimin e kontratës (e cila zakonisht nuk është në favor të Qeverisë). Kontratat zakonisht janë shumë komplekse dhe lejojnë hapësirë për negociata dhe apelim në gjykatë. Prandaj kontrata duhet të përcaktojë qartë situatën kur lejohet ri-negocimi i disa pjesëve të kontratës.

Në vitin e fundit të kontratës, kompania mund të mos ketë nxitje të mjaftueshme që të investojë pasi që nuk e ka të qartë nëse do të mund të rikuperojë investimin e bërë. Kjo mangësi mund të tejkalohet duke siguruar kompensim në fund të periudhës së koncesionimit në varësi me investimet e pa-amortizuara dhe gjendjen e ndërmarrjes, që do të nxiste operatorin privat t'i mirëmbajë asetet e ndërmarrjes. Që të dy, Qeveria dhe koncesionari mund të mos u përmbahen dispozitave të kontratës duke aplikuar çmime më të larta, duke mos u përgjigjur ankesave të konsumatorëve, duke prodhuar dhe ofruar produkte/shërbime të kualitetit të ulët, duke refuzuar aplikimin e çmimeve të akorduara. Këto zakonisht janë parapërgatitje për ri-negocim të kontratës. Ekziston gjithashtu mundësia që koncesionari mund të braktisë afarizmin e vet për shkak të falimentimit apo të gllabërimit nga Qeveria.

Koncesionet bartin më tepër risk tek afarizmat e tjerë, posaçërisht në vendet ku institucionet e ekonomisë së tregut nuk janë të qëndrueshme sa duhet dhe ku gjasat që shteti të ndërhyjë janë më të mëdha. Koncesionet janë më të rrezikshme për koncesionarin dhe financuesit e tyre. Toka dhe asetet nuk mund të përdoren si kolateral (peng) pasi që ato nuk i takojnë koncesionarit. E vetmja gjë që mund të përdoret si kolateral nga operatori i ri është e drejta në të hyra në të ardhmen; e cila varet nga shkalla e respektimit të kontratës nga ana e Qeverisë. Në këtë mënyrë kostoja e kapitalit është me e lartë, andaj kërkohet rrjedhë më e madhe e të hyrave për të siguruar ofrimin e shërbimeve – që do të thotë, shërbimi do t'u kushtojë më tepër Qeverisë apo qytetarëve. Vlerësohet se këto rreziqe e rrisin koston e kapi-

talit për 2-6%, varësisht nga vendi dhe sektori¹⁸. Investitorët që tenderojnë për koncesione e kanë parasysh riskun dhe binden që të hyjnë në proces vetëm nëse rreziqet janë të identifikuara në mënyrë eksplicite në kohën kur caktohen kriteret e tenderimit.

Megjithatë, problemi më i madh mbetet përpjekja potenciale që të ri-negociohet kontrata pasi që kjo do të dëmtonte procesin konkurrues mbi të cilin është bazuar kontrata.

Cilat kontrata kanë më shumë gjasë që të ri-negociohen? Përvojat e vendeve të tjera tregojnë se shumë marrëveshje koncesionale ri-negociohen dhe atë zakonisht në favor të koncesionarit dhe në kurriz të Qeverisë dhe konsumatorëve. Një studim i mbi 1.000 koncesioneve në Amerikën Latine dhe shtetet e Karaibeve, i referuar më sipër, identifikon elementet që kontribuojnë në rritjen e gjasave për të ri-negociuar kontratën.¹⁹ Më e rëndësishmja është se ky studim nënvizon mangësitë e koncesioneve: 41% e koncesioneve janë ri-negociuar; 61% e ri-negocimeve janë iniciuar nga operatori, 20% nga Qeveria dhe 24% nga të dyja palët. Gjasat që kontrata e koncesionimit të ri-negociohet kanë qenë më të mëdha në rastet kur kontrata është bazuar në propozimin e tarifës më të ulët sesa në pagesën më të lartë të transferimit; kur kanë përfshirë kërkesat për investime sesa indikatorët e performancës; kur janë bazuar në rregullimin e çmimit tavan sesa në rregullimin në bazë të normës së kthimit; marrëveshjet që janë arritur kur nuk ka ekzistuar rregullatori sesa kur ka ekzistuar; kur është formuluar si kontratë sesa si dekret apo ligj. Tabela në vazhdim përmbledh këta faktorë në mënyrë sasiore.

Tabela 1- Faktorët që kontribuojnë në ri-negocimin e kontratave dhe shpeshtësia e tyre

Veçoritë specifike të kontratës	Shpeshtësia e ri-negocimit (%)
Kriteri i dhënies së kontratës bazohet në:	
Tarifën më të ulët	60
Pagesën më të lartë të transferimit	11
Kriteret e rregullimit përfshijnë:	
Kërkesa për investime	70
Indikatorë të performancës	18
Metoda e përdorur e rregullimit:	
Çmimi tavan	42
Norma e kthimit	13
Ekzistenca e organeve rregullatore	
Nuk ekzistonin organet rregullatore	61
	17
Lloji i marrëveshjes	
Marrëveshja e bazuar në kontratë	40
Marrëveshja e bazuar në dekret	28
Marrëveshja e bazuar në ligj	17

18 Shih Guasch and Spiller (2001)

19 Autorët përdorin model probit për të matur ndikimin e një mori faktorësh në probabilitetin e ri-negocimit. Shih Guasch (2004), Kapitulli 6 dhe Guasch, Laffont and Straub (2003).

Burimi: adoptuar nga (2004), f. 86. Studimi është bazuar në mbi 1000 koncesione ne Amerikën Latine dhe shtetet e Karaibeve ndërmjet mesit të viteve 80-a dhe vitit 2000.

Si përmbledhje: përvojat e mbi njëzet vjetëve të marrëveshjeve koncesionare anë e kënd botës duhet t'u mundësojnë vendeve si Kosovës që të futen në koncesione si forma të privatizimit në mënyrë efektive. Një marrëveshje e suksesshme e koncesionimit kërkon shqyrtim të kujdesshëm të faktorëve nxitës të të dyja palëve, para-kualifikim efikas për të eliminuar palët joserioze, tenderë konkurrues nga një numër konkurrentësh dhe insistim nga të dyja palët në zbatimin e kushteve të kontratës. Kontrata duhet në mënyrë eksplicite t'i identifikojë kushtet në të cilat rinegocimi i kontratës është i arsyeshëm. Marrëveshja është më mirë të bazohet në ligj sesa në kontratë të nënshkruar nga ministria apo Qeveria. Në këtë mënyrë, jo vetëm se do të jetë nën llupën e procedurave parlamentare por do të ketë më pak gjasa që të jetë subjekt i pazarllëqeve në rastet kur ndërrohen qeveritë. Ofertuesit që ofrojnë kushte që janë "shumë të mira për të qenë të vërteta" siç janë tarifatat më të ulëta apo investime më të mëdha sesa rivalët e tjerë, duhet të verifikohen me më shumë kujdes. Ristrukturimi i këtyre sektorëve duhet t'u paraprijë koncesioneve që të sigurohet se faza të ndryshme të prodhimit janë mirë të përcaktuara dhe se linjat e përgjgjësisë dhe llogaridhënies janë të definuar qartë. Duhet kërkuar asistencë nga institucionet ndërkombëtare financiare për të dizajnuar kontratën dhe krijuar kriteret për dhënien e kontratës. Përfundimisht, i gjithë procesi duhet të zhvillohet me transparencë të plotë që të minimizojë mundësinë e korrupsionit dhe vënies nën kontroll të segmenteve kyçe në këtë proces dhe se kontratat e mëdha duhet të mbikëqyren dhe votohen nga Parlamenti.

3.2 Privatizimi i shërbimeve të telekomunikimit

3.2.1 Mësimet e nxjerra nga privatizimi i kompanive të Telekomunikacionit në vendet në tranzicion

Kompanitë e telekomunikimit kanë qenë shumë profitabile në shumicën e vendeve dhe si rezultat kanë qenë në krye të listave të shërbimeve publike për t'u privatizuar (Newbery, 1999). Por, pavarësisht profitabilitetit të tyre, gjenerimit të vendeve të reja të punës dhe kontributit në punësim, ato kanë ofruar kualitet të ulët të shërbimeve dhe performanca e tyre ka qenë nën standardet e kërkuara. Ristrukturimi dhe reformat në sektorin e telekomunikimeve kanë qenë parakusht i rëndësishëm për zhvillimin e këtij sektori dhe ekonomisë në përgjithësi (Berlage, 1995). Telekomunikimi modern, duke qenë një ndër sektorët kyç të shërbimeve, i cili kontribuon në rritjen e produktivitetit dhe zhvillimin e sektorëve të tjerë, ishte parakusht themelor për procesin e tranzicionit nga planifikimi qendror në ekonomi të tregut. Në mënyrë që të implementohen, adaptohen dhe të përfitohet nga këto zhvillime, investime të mëdha duhet të ndodhin në teknologjitë e reja për të zhvilluar infrastrukturën e kërkuar, të cilin investim mund ta ofrojë vetëm sektori privat (zakonisht investitori i huaj). Investitorët e huaj nuk do të ofrojnë vetëm teknologjinë dhe ekspertizën por gjithashtu edhe aftësitë për menaxhim dhe qasje në kapitalin e huaj.

Privatizimi ishte padyshim vetëm hapi fillestar në procesin e gjatë të tranzicionit dhe suksesi i tij ka qenë i lidhur me themelimin e rregullatorëve të pavarur dhe të fuqishëm, te cilët inkurajojnë pjesëmarrjen e sektorit privat, mbikëqyrin krijimin e një mjedisi konkurrues dhe mbrojnë konsumatorët nga mundësia e keqpërdorimit të fuqisë së tregut, që vjen si rezultat i pozicionit të tyre të fuqishëm në treg (Choi, 1995; Levy and Spiller, 1993).

Aktualisht, shumë vende kanë përfunduar në mënyrë të suksesshme privatizimin e kompanive të telekomunikimit. Qeveritë kanë shfrytëzuar dy metoda bazë për shitjen e aseteve të këtyre kompanive: shitjen direkte totale ose të pjesshme të kompanisë te një blerës i vetëm, përmes negocimit, ose shitjen e një pjese të aksioneve të kompanisë përmes ofrimit të aksioneve në treg. Pjesa më e madhe e ekonomive në tranzicion kanë përdorur shitjen direkte si metodë për privatizimin e kompanive të telekomunikimit, përderisa ofrimi i aksioneve në treg si metodë është përdorur vetëm në disa raste (si: Republika e Çekisë, Estonia, Hungaria dhe Polonia). Metoda e parë e privatizimit lejon më shumë hapësirë për presion politik dhe korrupsion, përderisa metoda e shitjes së aksioneve në treg është më transparente dhe është përcjell gjithmonë me më pak skandale (Megginson, 2005). Metoda e dytë, sidoqoftë, kërkon një nivel minimal të zhvillimit në tregjet financiare.

Shumica e qeverive të vendeve në tranzicion kanë mbajtur një pjesë të aksioneve të kompanive të telekomunikimit për përfitime vetanake ose për shitje te mëvonshme – në ndonjë kohë tjetër kur çmimet do të ngriheshin dhe shitja do të gjeneronte të hyra më të mëdha për shtetin. Të tjerët nuk kanë lejuar që pjesa e aksioneve të tyre të bjerë nën një nivel të caktuar, zakonisht 20 deri në 25 për qind e aksioneve kërkohet për të qenë aksionar “minoritet bllokues”. Disa vende e kanë të ndaluar edhe me kushtetutë, të lejojnë që pjesa e tyre në këto kompani të bjerë nën nivelin e lartpërmendur (Komisioni Evropian- Banka Botërore, 2007; Megginson, 2005 f. 308). Tabela në vazhdim, përmbledh një pasqyrë të privatizimit të kompanive të telekomunikimeve në disa vende në tranzicion (për më shumë detaje, ju lutem shikoni Shtojcën 3).

Tabela 2: Privatizimi i kompanive të telekomunikimit në disa vende në tranzicion

Vendet	Metoda e shitjes	Pjesa e shitur
Shqipëria	Shitja e aseteve	85%
Bullgaria	Shitja e aseteve	51%
Kroacia	Shitja e aseteve	35%
Hungaria	Shitja e aksioneve ne treg	30%
Maqedonia	Shitja e aseteve	51%
Serbia	Shitja e aseteve	49%

Burimi: Pjesë nga tabela 8.4 (Megginson, 2005)

Përderisa shumica e vendeve kanë shitur pjesën kontrolluese të këtyre kompanive, të tjerat kanë mbajtur shumicën e aksioneve në pronësi të tyre ose “pjesën e artë”

(Golden Share). Pothuajse në të gjitha rastet, blerësit kanë qenë kompani të huaja ose kompani me përvojë në këtë sektor dhe me fonde të mjaftueshme për të investuar jashtë vendeve të tyre. Shqipëria, për shembull, ia ka shitur 85% të aksioneve kompanisë Cosmote/Telenor, një konsorcium i OTE (Greqi) dhe Telenor (Norvegji) dhe pagesa është bërë në dy pjesë. Hungaria ia ka shitur 17% të aksioneve kompanisë Deutsche Telecom (DT) qysh herët në vitin 1993, përderisa në vitin 2000 pjesa e aksioneve të DT-së në kompaninë hungareze Matav është ngritur në 59.52%, pjesa tjetër e aksioneve është mbajtur në pronë publike, përderisa "pjesa e artë" e aksioneve është mbajtur te Qeveria hungareze. Maqedonia dhe Mali i Zi ia kanë shitur pjesën kontrolluese të aksioneve Magyar Telecom, që është pronë (shumicën e aksioneve) e Deutsche Telecom, e cila gjithashtu ka blerë pjesën kontrolluese të aksioneve të kompanisë kryesore të telekomunikimit në Kroaci, pasi që fillimisht ka blerë 35% të aksioneve në tetor të vitit 1999. Serbia në anën tjetër ia ka shitur 49% të telekomit të saj kompanisë OTE (Greqi) dhe Stet (Itali) në vitin 1997. Bulgaria ka mbajtur "pjesën e artë" (Golden Share) të aksioneve pavarësisht shitjes së 50% të aksioneve tek OTE (Greqi) dhe KPN nga Holanda (Komisioni Evropian – Banka Botërore, 2007; Megginson, 2005). Duke e mbajtur "pjesën e artë" (Golden Share) të kompanisë, Qeveria mban të drejtën e vetos për çfarëdo vendimi strategjik të kompanisë në të ardhmen.

3.2.2. Aktivitetet dhe çështjet lidhur me privatizimin e Telekomunikacionit në Kosovë (Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës)²⁰

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) është themeluar në vitin 1959. Rregullorja e UNMIK-ut 2005/18 i ka dhënë Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) autoritetin për të transferuar ndërmarrjet publike në korporata. Në vitin 2005, AKM-ja ka transferuar PTK-në në Shoqëri Aksionare, të emëruar Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A. Përderisa, në vitin 2008 bazuar në nenin 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës emërohet aksionar i ri i Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës. Këtë vit, PTK-ja është kontraktuar edhe me licencën e katërt të telefonisë mobile në Shqipëri, në partneritet me një konsorcium lokal. PTK-ja do të këtë në pronësi 30 për qind të operatorit të ri mobil, ku pjesa tjetër prej 70 për qind do të jetë e ndarë në mes të Union Group, Infosoft, Albania Drink Distribution dhe ACI Engineering. Ky aktivitet do të mund të rrisë vlerën e përgjithshme të PTK-së.

PTK-ja ka katër njësi kryesore të biznesit:

1. Posta e Kosovës.
2. Telekomuni i Kosovës.
3. Vala – operatori mobil, dhe
4. DardaNet – shërbimi i internetit.

²⁰ Kjo pjesë është shkruar bazuar ekskluzivisht nga të dhënat sekondare, meqenëse ka qenë e pamundur të caktohet një takim me zyrtarët e PTK-së.

Të katër njësitë e biznesit të PTK-së janë të licencuara nga Autoriteti Rregullues i Telekomunikacionit (ART). PTK-ja është gjithashtu e organizuar edhe në disa njësi mbështetëse, si: Drejtoria e Financave, Drejtoria e Shitjes, Drejtoria Ligjore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Trajnimit dhe Zhvillimit, dhe Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun.

Njësia e Postës: Banka Qendrore e Kosovës ka lëshuar për PTK-në licencën jo-bankare financiare, e cila i lejon Postës të ofrojë pagesa në "kesh" dhe shërbime të pranimit për palët e treta. Në maj të vitit 2006, Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit ka lëshuar për PTK-në licencën për ofrim universal të shërbimeve postare.

Njësia e Telefonisë fikse: kjo njësi është i vetmi rrjet i licencuar dhe i vetmi ofrues i shërbimeve të telefonisë fikse në territorin e Kosovës. Njësia e telefonisë fikse ofron gjithashtu edhe shërbimet e internetit qysh nga viti 2001, dhe sot është njëri ndër tre operatorët të cilët ofrojnë shërbime të internetit në Kosovë, të autorizuar nga ART-ja. Njësia e telefonisë fikse u shërben rreth 200,000 konsumatorëve. Aktualisht, kjo njësi shfrytëzon kodin telefonik të Serbisë. Mungesa e kodit vendor telefonik mund të rezultojë në uljen e vlerës së njësisë në veçanti, por edhe të PTK-së në tërësi.

Njësia e Telefonisë mobile VALA: Vala është njësi e telefonisë mobile GSM dhe aktualisht është njëri ndër dy operatorët e licencuar për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit mobil në Kosovë. Aktualisht, shërbimet e Vala-s mbulojnë rreth 90% të territorit gjeografik dhe më shumë se 85% të popullatës së Kosovës. Të ardhurat nga telefonia mobile paraqesin burimin më të madh të të ardhurave për PTK-në, duke grumbulluar më shumë se 70% të të ardhurave totale të PTK-së çdo vit. Pjesë-marrja e kësaj njësi në të ardhurat totale është rritur çdo vit, nga 62% në vitin 2002 në 68% në vitin 2004, kurse tani në më shumë se 70%. Njësia e Telefonisë mobile Vala u shërben më shumë se një milion konsumatorëve. Si rezultat, Vala është njësia kyçe e biznesit të PTK-së dhe është shumë atraktive për investitorët e huaj.

PTK-ja në vitin 2000 ka nënshkruar marrëveshje për të ofruar shërbime të telefonisë mobile në Kosovë me Monaco Telecom International (MTI), e cila marrëveshje i jep të drejtën PTK-së të shfrytëzojë kodin telefonik të MTI-së dhe i jep të drejtën PTK-së që të lidhë rrjetin e saj mobil me rrjetet ndërkombëtare. Si pjesë e kësaj marrëveshjeje, PTK-ja duhet të kompensojë Monaco Telecom International (MTI) për një pjesë të të ardhurave dhe të paguajë disa kosto ndërkombëtare. Marrëveshja gjithashtu përfshin shfrytëzimin e shërbimit Roaming dhe transferin e njohurive të MTI-së në PTK. Marrëveshja përmban një klauzolë të shkëputjes në rastin kur Kosova të kërkojë Kodin telefonik ndërkombëtar të saj. Është shumë me rëndësi që Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit të zgjidhë problemin e Kodit telefonik sa më shpejtë që është e mundur, sepse mungesa e Kodit telefonik mund të rezultojë në uljen e vlerës së kësaj njësie dhe PTK-së në përgjithësi.

PTK-ja ka një influencë të fuqishme në operimet e sektorëve të tjerë të ekonomisë, si ofrues i inputeve shumë të rëndësishme siç janë telekomunikimet. Si rezultat, çdo përmirësim në performancën e kësaj kompanie do të kishte ndikime direkte dhe të fuqishme në ekonominë dhe shoqërinë e Kosovës. PTK-ja me rreth 3200 punëtorë, sa ka aktualisht, është njëri ndër punëdhënësit më të mëdhenj në Kosovë dhe është një ndër kompanitë më profitabile (me më shumë se 80 milionë euro profit operativ

për vitin 2008). Të hyrat e kësaj kompanie janë ngritur vazhdimisht deri në vitin 2007, dhe profiti operativ është ngritur deri në 148 për qind gjatë kësaj periudhe. Përderisa në anën tjetër, kemi një rënie të profitit operativ për periudhën 2007 – 2008, prej rreth 17 milionë euro²¹. Kjo rënie mund të jetë rezultat i rënies në të ardhurat e PTK-së për shkak të hyrjes së operatorit të ri mobil në tregun e Kosovës. Deri vonë, PTK-ja ka pasur monopol në shërbimet e telekomunikacionit në Kosovë, kurse në vitin 2007, Qeveria licenoi operatorin e dytë mobil, IPKO, përderisa në vitin 2008 licenoi edhe dy operatorë mobilë virtualë, Dardafone dhe D3 mobile. Profitabiliteti i PTK-së është në nivel të lartë rezultat i pozitës monopoliste që kjo kompani ka pasur në treg dhe thjeshtësisë për të mbledhur të ardhurat e veta nga shërbimet (rast i kundërt nga KEK-u). Sidoqoftë, pavarësisht këtij suksesi në treguesit e profitabilitetit, PTK-ja ka një histori dhjetëvjeçare të keqmenaxhimit dhe aferave korruptive²². Ka mungesë të transparencës lidhur me procedurat e dhënies së tenderëve, lidhur me procedurat e punësimit (PTK-ja konsiderohet të jetë e mbi-punësuar dhe si rezultat joeficiente)²³ dhe lidhur me pagat e menaxherëve. Vazhdimisht ka pasur vështirësi në përzgjedhjen e menaxhmentit të lartë dhe procesi ka qenë i ndikuar politikisht. Në disa raporte të botuara në Kosovë viteve të fundit²⁴, PTK-ja perceptohet nga publiku i gjerë si njëra ndër institucionet më të prekura nga korrupsioni.

Si rezultat i kësaj situatë, ekziston një konsensus në mesin e palëve me interes dhe shoqërisë në përgjithësi për privatizimin e kësaj kompanie, por gjithashtu shtrohen ende pyetje lidhur me faktin se si të privatizohet kjo kompani, a është ky momenti i duhur për privatizim dhe me çfarë procedurash dhe modelesh të privatizohet kjo kompani?

Edhe pse Qeveria ka shpallur vendimin për privatizimin e PTK-së në mesin e ndërmarrjeve të tjera publike në Kosovë, ka mungesë të informacioneve, përveç vendimit, lidhur me këtë çështje. Sipas ministrit të Ekonomisë dhe Financave²⁵, i vetmi hap përpara në këtë çështje është shpallja e KpP (kërkesës për propozime) për ofrim të shërbimeve këshilluese të transaksionit për strukturimin dhe ekzekutimin e pjesëmarrjes private në PTK. Deri më tani, Ministria nuk e ka zgjedhur "këshilltarin e transaksionit", i cili do të këshillojë ata lidhur me modelin e privatizimit. Edhe në rastet kur ministritë zgjedhin këshilltarët e transaksionit, publiku i gjerë nuk ka kurrfarë qasje në prapavijën e këtyre këshilltarëve dhe në dokumentacionin e përgatitur nga ta. PTK-ja nuk është përgjigjur në disa tentime tona për të organizuar takim me ta dhe për të diskutuar çështjen e privatizimit. Në këtë aspekt, duhet të theksojmë se deri më tani ka pasur mungesë të vazhdueshme të transparencës dhe nuk ka pasur debat publik lidhur me privatizimin e PTK-së. Pyetjet si, çka do të ndodhë me të ardhurat që vijnë nga privatizimi, a do të mbajë Qeveria një pjesë të aksioneve në pronë të saj, a do të përfshijë procesi i privatizimit vetëm njësinë e telefonisë mobile Vala apo Vala dhe njësitë e tjera, mbesin pa përgjigje.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave në Kornizën e fundit Afatmesme të Shpenzi-

- 21 Pasqyrat financiare të PTK-së, të publikuara në faqen zyrtare të internetit.
 22 Ish drejtoresha e PTK-së është e dënuar me katër vite burg, për veprim korruptiv në këtë kompani.
 23 Rreth 700 punëtorë janë punësuar vetëm gjatë 12 muajve të fundit.
 24 "Raporti i paralajmërimit të hershem" nga UNDP dhe "Raporti i Korrupsionit në Kosovë 2004" nga UNDP
 25 Intervistë me ministrin e Ekonomisë dhe Financave, të realizuar nga ekipi i projektit

meve (KASH) 2010 – 2012, deklaroi se PTK-ja do të shitet si tërësi në një të afërme të afërt dhe se ky proces do të rezultojë në shitje të asetëve me vlerë prej 500 milionë eurosh²⁶. Sipas këtij dokumenti, këto financa (të hyra) do të mund të shfrytëzohen për shpenzimet publike të ardhshme. Në besojmë se caktimi i vlerave, duke i paraprirë çfarëdo procesi të privatizimit, mund të jetë i dëmshëm për vetë procesin. Në vend të përcaktimit të vlerave, ne do të sugjerim të krijohet kushte për ofertim transparent dhe konkurrencë fer, pa paragjykime lidhur me vlerën e tregut, sepse kjo do të mund të qonte në keqinterpretime nga ana e investitorëve.

Rekomandimi ynë kryesor në fazën fillestare të privatizimit të PTK-së është që Qeveria të mbajë një përqindje të konsiderueshme të aksioneve në pronësi të saj, deri në nivelin që nuk do të dekurajonte investitorët potencialë. Argumenti kryesor për të mbajtur një pjesë të aksioneve në pronësi publike lidhet me faktin që Qeveria do të mund të vazhdonte me tërheqje të dividendës nga profitet eventuale të kompanisë për një kohë të caktuar dhe do të mund të shiste ato aksione në një kohë tjetër, kur vlera e këtyre aksioneve të jetë më e lartë.

3.3 Privatizimi i sektorit të energjisë

3.3.1 Mësimet e nxjerra nga privatizimi i sektorit të energjisë në ekonominë e tranzicionit

Rasti i privatizimit të energjisë elektrike është më pak i drejtpërdrejtë për shkak të natyrës vertikalisht të integruar të kompanive në këtë sektor dhe rrjedhimisht kompleksitetit të kombinimit të prodhimit, bartjes dhe distribuimit të energjisë elektrike (nganjëherë edhe në faza më të hershme si minierat e thëngjillit) në një kompani, dhe pjesërisht sepse shumë nga këto kompani në tranzicion kanë qenë dhe mbeten joprofitabile për shkak të humbjeve teknike, vjedhjeve, mospagesave të faturave, etj.. Tani është pranuar në përgjithësi, dhe e miratuar si politikë e përgjithshme e qeverisjes në vendet e Bashkimit Evropian nevoja për ndarjen vertikale të pjesëve të ndryshme të tërësisë së integruar dhe futjen e konkurrencës në nivelet e prodhimit dhe shpërndarjes.

Energjia elektrike mund të prodhohet në mënyra të ndryshme duke përdorur teknologji të ndryshme. Nuk ka asnjë justifikim teknologjik mbi prodhimin i cili duhet të koncentrohet në një kompani. Për të pasur një hyrje falas në nivelin e prodhimit duhet të merret parasysh një matje e hershme në procesin reformues që është mjaft e rëndësishme. Faza e transmissioinit përbëhet nga rrejtja kombëtare i shpërndarjes, i cili përbën elementin kryesor monopolist të industrisë. Dyfishimi i një rrjeti të tillë do të ishte ekonomikisht i kotë dhe për këtë arsye në shumë vende sistemi i transmissioinit drejtohet dhe është pronë e një kompanie të vetme me pronësi shtetërore²⁷. Në fund faza e distribuimit, e cila sjell energjinë elektrike deri të shfrytëzuesit industrialë, afaristë dhe rezidencialë, ka disa karakteristika të

26 Disa ekspertë të kësaj fushe, duke përfshirë edhe ish-drejtorin e PTK-së Etrur Rrustemaj, kanë vlerësuar vlerën e PTK-së rreth 1 miliard euro, Koha Ditore, qershor 2009.

27 Fakti se ekziston një element i fortë i monopolit natyral në transmissioin nuk parqet një situatë ku automatikisht do të duhet të ketë një formë private të pronësisë. Është e mundshme për këtë fazë që të privatizohet si monopol i rregulluar nga një rregullator i pavarur (si për shembull në Mbretërinë e Bashkuar).

natyrës monopoliste pasi që përdoret një rrjet fizik i përcjellësve, transformatorëve dhe objekteve të ndryshme për të siguruar energjinë elektrike te secili konsumator individual. Sidoqoftë, shumë nga detyrat e përfshira në këtë proces (si matja, faturimi dhe shërbimi individual i shfrytëzuesve të rrymës) mund të ndërmerren nga operatorë të tjerë në një ambient konkurrues. Konkurrenca në fushën e alokimit apo distribuimit mund të arrihet duke u siguruar qasje kompanive individuale tregtare në rrjetin e shpërndarjes dhe qasje ndaj konsumatorëve bazuar në çmimet e rregulluara.

Direktivat e Energjisë Elektrike të BE-së kanë për synim sigurimin e qasjes në rrjetin e distribuimit për palët e treta për përdorim duke u bazuar në ndarjen e drejtë të kapaciteteve, me një pagesë të drejtë dhe të arsyeshme në aspektin praktik dhe teknik (Bielecki and Desta, 2004). Qasja e palëve të treta (TPA) apo sistemi alternativ i quajtur "Single Buyer" "blerës i vetëm" i ndërtuar në BE Electricity Directive, paraqet modele të cilat lejojnë qasje në rrjetat e transmisionit dhe distribuimit. Qasja e palëve të treta është e rregullueshme dhe e negociueshme. Te qasja e palëve të treta të rregulluara, këto palë kanë të drejta ndaj qasjes duke u bazuar në kushtet e paracaktuara nga rregulluesi, përderisa te TPA-të e negociuara, palët e treta negociojnë me operatorët e transmisionit apo distribuicionit. Në anën tjetër te sistemi i blerësit të vetëm, blerja e energjisë elektrike dhe shitja e saj bëhet nga operatori i transmisionit.

Privatizimi i sektorit të energjisë në ekonominë në tranzicion ka filluar në fillim të viteve të '90-a dhe shumica e tyre kanë hyrë në disa forma të privatizimit në këtë sektor.

Në shumë vende të Evropës Juglindore, sigurisht që pjesa më e madhe e industrisë së energjisë elektrike janë në pronësi shtetërore dhe parapërgatitja për privatizim nuk është finalizuar ende. Si shembull kemi Bosnjën e Hercegovinën, ku tri nga kompanitë e energjisë elektrike janë ende të integruara vertikalisht, sidoqoftë planet për ta shpërbërë, ristrukturuar dhe privatizuar sektorin e energjisë janë në zhvillim. Gjithashtu, në Serbi industria e energjisë pas liberalizimit, vepron përmes dy ndërmarrjeve publike, "Industria e Energjisë Elektrike e Serbisë" (IEES), e cila është njëherësh i vetmi shpërndarës në Serbi, "Elektromreža Srbije" (EMS) që është edhe i vetmi shpërndarës tërësisht i shturur. Industria e energjisë në Kroaci karakterizohet me një pjesë më të madhe në pronësi shtetërore. Përderisa sistemi i operimit të tregut dhe transmisionit është legalisht i shturur, së paku 51% e Korporatës Elektro Energjetike (HEP) do të mbetet në pronësinë shtetërore derisa Republika e Kroacisë të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian²⁸.

Shumica e qeverive të ekonomive në tranzicion kanë mbajtur nën kontrollin e tyre elementin e shpërndarjes. Shembull kemi Bordin e Energjisë Elektrike të Hungarisë, i cili ka mbajtur nën kontroll rrjetin e transmisionit dhe i cili figuron si "blerës i vetëm" në sistemin e energjisë elektrike të Hungarisë përderisa distribuimi është kryesisht i privatizuar dhe dominojnë kompani të huaja. Në Slloveni kompania e transmisionit mbetet pronë shtetërore dhe vepron si blerës i vetëm në tregun e energjisë elektrike derisa forma e pronësisë private është zhvilluar në sektorin e prodhimit dhe distribuimit. Në Maqedoni ish-ndërmarrja nacionale e shërbimeve publike

28 Të dhëna lidhur me tregun e energjisë në ET-të janë siguruar nga Energy Country Profiles e ofruar nga Agjencia Austriake për Energji (<http://www.energyagency.at>); të dhëna të tjera përfshijnë EBRD (vite të ndryshme).

“Elektrostopanstvo na Makedonija” (ESM) është ndarë në kompani të veçanta të saj për prodhim dhe distribuim. Në pranverën e vitit 2006, shërbimet publike të Austrisë EVN kanë fituar 90% të kompanisë së distribuimit. Ekzistojnë plane për privatizimin e prodhimit, përderisa transmissioni mbetet në pronësi shtetërore. “Nationalna Elektricheska Kompania” (NEK), në Bullgari e themeluar më 1992 ka pasur të drejtën e prodhimit, transmissioinit dhe distribuimit deri nga mesi i vitit 2000. Sidoqoftë kjo kompani (NEK) pati vetëm të drejtën e transmissioinit në vitin 2001. Sektorët e tjerë, përkatësisht ai i prodhimit dhe distribuimi, janë privatizuar ose janë në procesin e privatizimit. Në Rumani, kompania nacionale e energjisë elektrike e mëparshme ish-CONEL është shkrire dhe zëvendësuar nga kompani komerciale të cilat kanë për detyrë prodhimin, bartjen dhe distribuimin. Qasja ndaj rrjetit është e rregulluar përmes palëve të treta, formë kjo e cila është përdorur edhe në vende të tjera si në Estoni dhe në Republikën e Çekisë.

Shturja vertikale ka përjetuar një progres gjatë viteve të fundit. Shqipëria, Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (FYROM), Serbia dhe Kosova kanë shturur operatorët e sistemeve të transmetimit (OST) si dhe Bosnja e Hercegovina ka shturur gjithashtu OST-in në mënyrë legale, përderisa Mali i Zi ka një OST funksional të shturur. Sidoqoftë në Kroaci HEP Group përbëhet nga një numër kompanish që e mbulojnë prodhimin, bartjen dhe distribuimin, në këtë rast operimet lidhur me bartjen janë pjesë e të njëjtit grup që figuron si prodhues kryesor. Megjithatë, ekziston edhe një operator i veçantë në treg i cili është pronë e Republikës së Kroacisë. Shturja në mes të prodhimit dhe distribuimit (duke përfshirë edhe furnizimin) nuk ka arritur shumë.

Në Shqipëri distribuimi i KESH-it është shturur dhe privatizuar. Sa i përket prodhimit, KESH-i është i obliguar t’u shesë furnizuesve privatë me çmime të rregulluara.

Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë distributori tani është nën pronësi të EVN të Austrisë, por edhe prodhuesit tjetër dominues ELEM i është e duhur shitja me çmime të rregulluara. Në mesin e palëve të tjera të “mbetura”, prodhimi dhe distribuimi/furnizimi bëhet nga e njëjta kompani ose grup kompanish, të cilat mund të shturen legalisht. Tabela në vijim paraqet përmbledhjen e shkallës së shturjes vertikale në vendet e Ballkanit.

Table 3. Shkalla e shturjes vertikale

	Sistemi i transmetimit dhe operatori i tregut	Prodhimi dhe distribuimi
Shqipëria	OST-të 100 % ndërmarrje shoqërore të shturura ligjërisht	KESH- distribuimi i shturur dhe në proces të privatizimit. Distributorë shtesë të cilët shesin në zonat "non-KESH".
Kroacia	Kompani e legalisht e shturur legalisht, por një pjesë e grupit HEP. Operatori i tregut është 100% nën pronësi shtetërore.	HEP-Grup me shumë kompani të lidhura në vlerën zinxhimore të energjisë
FYROM	Sistemi i transmetimit dhe operatori i tregut 100% nën pronë shtetërore të shturura legalisht.	Distributori i privatizuar (EVN-ja austriake). Prodhuesi kryesor, ELEM, është i obliguar të shesë nën çmime të rregulluara.
Mali i Zi	OST funksionale të shturura	Katër divizione të shturura funksionale (prodhimi, transmetimi, distribuimi dhe furnizimi).
Serbia	OST të shturura legalisht me 100% nën pronësi shtetërore.	Prodhimi dhe distribuimi/furnizimi të integruara. Filiale të pavarura legale. OST funksionale të shturura legale nga operime të tjera.
Kosova	OST të shturura legalisht me 100% nën pronësi shtetërore.	Prodhimi dhe distribuimi/furnizimi të integruara.

Burimi: South East Europe Wholesale Market Opening, Pöyry Energy Consulting and Nord Pool Consulting, March 2009

Një pikë tjetër e cila duhet përmendur në këtë sektor është se reforma e energjisë elektrike duhet të bazohet në mbulimin e shpenzimeve dhe funksionet e Qeverisë për mirëqenie duhet të ndahen nga politikat e energjisë elektrike.

3.3.2 Aktivitetet dhe çështjet lidhur me privatizimin e sektorit të energjisë në Kosovë (Korporata Energjetike e Kosovës – KEK)

KEK-u është kompania furnizuese e vetme e energjisë në Kosovë, e integruar vertikalisht me katër sektorë kryesorë: Prodhimi i Thëngjillit, Gjenerimi, Distribuími dhe Furnizimi. Ristrukturimi i pjesshëm përfundoi në nëntor 2005 duke rezultuar me ndarjen e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), i cili operon i pavarur nga KEK-u. Shtatorin e kaluar, Qeveria e Kosovës, si aksionar i vetëm e avancoi procesin e ndarjes së kompanisë në dy kompani: Kompaninë e Prodhimit (e cila prodhon thëngjill dhe rrymë) dhe Kompaninë e Distribuímit (e cila e distribuon energjinë dhe merret me shitjen). Kjo e fundit do t'i nënshtrohet procesit të privatizimit.

KEK-u trashëgoi kushte shumë të vështira në vitin 1999 pas një dekade të keqmenaxhimit dhe mungesës së investimeve. Pas luftës, janë bërë shumë investime kryesisht nga donatorët e huaj. Periudha kur kontratat e menaxhimit janë nënshkruar paraqet hapat inicialë të përfshirjes të sektorit privat. Sipas drejtorit menaxhues të KEK-ut, këto kontrata nuk kanë dhënë rezultatin e pritur për shkak të mungesës së koordinimit ndërmjet palëve. Prandaj kjo rezultoi me vonesa dhe me mungesë të informatave të sakta lidhur me investimet e bëra nga donatorët. Sipas të njëjtit burim, këto informata nuk janë ndarë me përfituesin, në këtë rast KEK-un. Problemet ishin të dyfishta, së pari, personeli lokal ishte lënë mënjanë në të shumtën e rasteve dhe kishte mungesë të përcaktimit të objektivave që duhet të arrihen. Kontratat e menaxhimit kanë treguar rezultat të ulët pasi që kryesisht ishin të fokusuar në arritjen e objektivave duke mos e shfrytëzuar ekspertizën lokale.

KEK-u ka përafërsisht 372,000 klientë, shumica e të cilëve janë konsumatorë shtëpiakë dhe kompania i ka 7500 të punësuar në funksione të ndryshme. Sipas drejtorit menaxhues të KEK-ut, Sindikata e punëtorëve e kësaj kompanie (SPEK) është pajtuar me procesin e privatizimit dhe shpreh gatishmërinë të bashkëpunojnë me Qeverinë në përgatitjen e pakove të shpërbllimit për ata të cilët do ta humbin punën si pasojë e procesit të privatizimit.

Faturimi dhe inkasimi mbesin problemi më i madh i KEK-ut. Në vitin 2008, deri në prill humbjet teknike të KEK-ut mbërrinin deri 18%. Vetëm 76% e energjisë së prodhuar është faturuar, nga e cilat vetëm 61% ënjtë inkasuar, me një total prej vetëm 46.3% të inkasuar nga furnizimi i përgjithshëm. Borxhet e konsumatorëve e mbërrijnë shumën €400 milionë, prej të cilës afërsisht gjysma është borxh i enklavave serbe. Sipas drejtorit menaxhues të KEK-ut, kompania është në përmirësim të vazhdueshëm të inkasimit të borxheve, por ajo nuk e ka arritur ende më të mirën pasi që i mungon edhe mbështetja e gjykatave në procesimin me kohë të çështjeve gjyqësore të cilat i ka filluar KEK-ut kundër konsumatorëve borxhlinj. KEK-u në vitin 2008 ka shënuar rritje në inkasimin e borxheve, faturimin, dhe prodhimin krahasuar me vitin 2007, gjithashtu ka arritur t'i ulë humbjet komerciale me 5% vetëm brenda një viti. Sipas drejtorit menaxhues të KEK-ut, kompania nuk arrin ta mbulojë koston e prodhimit. Si rezultat i performancës operationale dhe financiare të KEK-ut, sektori i energjisë është shndërruar në pengesë në rritje por gjithashtu edhe një barrë fiskale. Qeveria ka shpenzuar shuma të konsiderueshme patash nga buxheti për ta

mbajtur KEK-un gjallë dhe për importimin e energjisë. Gjatë periudhës 2000-2007, nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës janë ndarë më shumë se 273 milionë euro në formë të subvencioneve për KEK-un, që rezulton të jetë 85% e shumës totale të ndarë për subvencion për NSH-të²⁹. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2009, shuma e subvencioneve për KEK-un arriti shumën 37.15 milionë euro, shumë e cila është për 25.4% më e madhe sesa shuma e ndarë për KEK-un për periudhën e njëjtë të vitit 2008³⁰. Me gjithë faktin që ndërprerjet e energjisë janë reduktuar, ato ekzistojnë ende në zonat rurale ku përqindja e inkasimit të borxheve është e ulët. KEK-u po ashtu konsiderohet si një institucion që është i zhytur thellë në korrupsion (EWS). Privatizimi i sektorit të prodhimit të energjisë, distribuimit dhe furnizimit duhet të merret në konsideratë dhe të implementohet në formë rrugëdaljeje nga kjo situatë. Buxheti i kufizuar për mbështetjen e investimeve në infrastrukturë, arsim dhe shëndetësi duhet të përdoren.

Sa u përket resurseve të limituara buxhetore lidhur me mbështetjen financiare në investimin e infrastrukturës, edukimit dhe shëndetësisë duhet menaxhuar më mirë nga ajo që bëhet tani në drejtim të subvencionimeve të KEK-ut dhe importimit të energjisë elektrike. Në memorandumet e fundit FMN-ja insiston në privatizimin e këtyre pjesëve.

Për shthurjen e divizioneve si minierave të KEK-ut, prodhimit dhe distribuimit/furnizimit kërkohet të bëhet nën Direktivat e EC dhe Traktatit të Kartës së Energjisë, si dhe vendimit të Qeverisë së Kosovës N.03.14 më 3 prill 2008, e cila kërkon që Strategjia Energjetike e Kosovës të rezultojë në një rrjet të privatizuar distribuimi. Kosova është nënshkruese e Memorandumit të Athinës 2002 dhe Memorandumit të Athinës 2003, që themelon Komunitetin e Energjisë për Evropën Juglindore (KEEJ) Ky traktat kërkon prej palëve nënshkruese që të jenë në pajtueshmëri me acquis communautaire të Komisionit Evropian i bazuar në kornizën kohore e cila ofron kohë të mjaftueshme për implementimin e përshtatshëm të reformës.

Sipas drejtorit menaxhues të KEK-ut pritet që procesi i privatizimit të sektorit të distribuimit dhe furnizimit do të rezultojnë me rritjen e investimeve në këtë sektor dhe gjithashtu në ngritjen e kualitetit të shërbimeve për klientët. Ata mendojnë që ky biznes mund të zhvillojë edhe shërbime të tjera dhe jo vetëm shitjen e energjisë elektrike. Kompanitë e telekomunikimit mund t'i përdorin këto asete për shpërndarjen e internetit, televizioneve kabllore, zonat e mbulimit digjital etj. Në këtë rast këto asete të distribuimit bëhen shumë atraktive. Sidoqoftë sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve parashihet që të ardhurat nga privatizimi të jenë afërsisht 30-50 milionë euro. Ekipi i projektit të Riinvestit konsideron që, sikur në rastin e PTK-së, supozimi i çmimit para vlerësimit është neglizhencë e këtyre institucioneve.

Privatizimi do të kryhet në përputhje me Strategjinë e energjisë, Ligji No. 03/L-087 mbi Ndërmarrjet Shoqërore, procedurat e tenderimit Ligji No. 02/L-44 mbi Procedurën e Fitimit të Drejtës Koncesionare, vendimet qeveritare të azhurnuara dhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve lidhur me shthurjen dhe privatizimin e KEK-ut. Rrjeti i Distribuimit dhe bizneset furnizuese pas shkëputjes nga KEK-u do të vendosen në një entitet legal të ri ("Disco"). Disco do të jetë sistemi operativ i

29 Departamenti i Thesarit, MEM – Shpenzimet nga buxheti i konsoliduar i Kosovës për ndërmarrjet shoqërore viti 1999-2007

30 Departamenti i Thesarit, raporti i gjysmëvjetorit, 2009

distribuimit dhe do të zotërojë, mirëmbajë dhe rrisë rrjetin e distribuimit në Kosovë. Furnizimi do ta blejë energjinë dhe do t'ia shesë atë konsumatorëve.

Qeveria e ka aprovuar shturjen e KEK-ut (Vendimi Nr. 04/36), privatizimin e aksioneve të sektorit të Distribuimit dhe Furnizimit (Vendimi Nr. 03/38) dhe ka caktuar Komisionin e Privatizimit (KP) për ta zbatuar privatizimin (Vendimi Nr. 08/39). Për zbatimin e privatizimit, qeveria ka krijuar dhe autorizuar Komisionin e Privatizimit i cili do të krijojë politikat dhe do të sigurojë koordinimin ndër-ministror përgjatë të gjitha fazave të projektit. Ai duhet të mbikëqyrë zbatimin në kohë të projektit. Këta këshilltarë dhe ekspertë duhet të ofrojnë ndihmë teknike dhe/ose shërbime këshilluese lidhur me projektin. Këta këshilltarë do të jenë të njohur si Komisioni Këshillues i Projektit (KKP). Anëtarët e KKP-së do të jenë të autorizuar të japin rekomandime, këshilla mbi implementimin e projektit dhe t'i ofrojë asistencë Komisionit të Privatizimit.

Këshilltari mbi transaksionet do të angazhohet me tender ndërkombëtar dhe do të sigurojë shërbime strategjike, legale, teknike dhe financiare për Komisionin e Privatizimit lidhur me strukturimin dhe implementimin e të gjitha fazave të projektit. Sidoqoftë, tenderi për këshilltarin mbi transaksionet është anuluar kohët e fundit për shkak të mungesës së tri ofertave teknikisht të pranueshme. Prandaj procedura u zgjat pothuajse për një vit. Vendimet e Qeverisë për të filluar privatizimin e sektorit të distribuimit dhe furnizimit deri më tani nuk janë diskutuar dhe aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Nuk ka një politikë të qartë nëse privatizimi i sektorit të distribuimit dhe furnizimit do të ofrohen në një pako të përbashkët dhe se si do të sigurohet konkurrenca përmes përfshirjes së më shumë operatorëve privatë në furnizimin me energji elektrike.

Privatizimi i "Kosovës B" është diskutuar gjithashtu së fundmi si një transaksion, brenda ose jashtë projektit "Kosova e re", një kapacitet i ri i prodhimit të energjisë i cili do të ndërtohet në partneritet me një investitor të huaj. Nuk ekzistojnë politika të qarta qeveritare lidhur me procedurat dhe modelet që do të përdoren për privatizimin e distribuimit, furnizimit dhe prodhimin e energjisë në njësitë e Kosovës B. Për të qenë më konciz në këtë drejtim nuk dihet se sa % të aksioneve do të jenë pronë publike. Gjithçka ka mbetur nën këshillën e këshilltarit të transaksionit të zgjedhur nga MEM, por raportet e tyre mbeten konfidenciale dhe të ekspozuara ndaj çdo debati nga organet e ngushta qeverisëse. Ne ju këshillojmë që modelet, procedurat dhe elementet e tjera kyçe të politikave të prezantohen në opinion dhe t'u prezantohen aksionarëve të interesuar para vendimeve finale dhe këto elemente kyçe lidhur me politikat, procedurat dhe modelet të diskutohen dhe aprovohen nga Kuvendi i Kosovës. Në këtë relacion korniza legale e tashme duhet të kompletohet dhe rishikohet.

3.4 4 Koncesionimet e Aeroportit

3.4.1 1 Mësimet e nxjerra nga koncesionimet e aero- porteve në Ekonomitë në Tranzicion

Kërkesa për udhëtim ajror dhe rrjedhimisht, infrastruktura aeroportuale, janë rritur më shumë se cilado degë tjetër e ekonomisë në tërësi dhe pritet që ky trend i rritjes të vazhdojë në të ardhmen e afërt (Andrew and Dochia, 1999). Për këtë arsye, sektori i transportit ajror u bë një sektor i rëndësishëm në të gjitha ekonomitë, veçanërisht në ekonomitë në tranzicion, duke kontribuar në gjenerimin e punësimit dhe rritjen ekonomike. Infrastruktura e trashëguar dhe objektet përcjellëse në përgjithësi ishin të vjetra dhe në nevojë për investime të mëdha kapitale për modernizim, për të përmbushur kërkesën e bizneseve dhe qytetarëve. Këto investime të mëdha, bashkë me rolin e ri-definuar të shtetit e kanë transformuar krejtësisht këtë sektor (Juan, 1996). Qeveritë e Ekonomive në Tranzicion kanë qenë të interesuara që të përfshijnë sektorin privat në modernizimin e infrastrukturës aeroportuale për dy arsye kryesore: sepse sektori privat do të dinte të menaxhonte në mënyrë më eficiente me ofrimin e shërbimeve të kërkuara në aeroporte (aterrimin dhe hapësirën për kompani vendore dhe të huaja, menaxhimin e bagazhit, mirëmbajtjen, dyqanet e aeroportit dhe zgjerimin adekuat të kapaciteteve) dhe për shkak të reduktimit të barrës në buxhetin qeveritar (duke pasur parasysh se aeroportet tradicionalisht kanë kërkuar kontribute nga qeveria, ndonëse jo në të gjitha rastet), që erdhi me kërkesën qeveritare. Në anën tjetër, ky veprim po ashtu redukton barrën dhe rrezikun fiskal dhe mund të përmirësojë bilancin financiar të qeverisë.

Duke marrë parasysh natyrën afatgjatë të investimeve në aeroporte dhe në infrastrukturën e tyre, sektori privat do t'i konsideronte këto projekte investuese si dobiprurëse po që se do të garantohej një normë e arsyeshme dhe e drejtë e kthimit të investimeve. Pjesëmarrja e sektorit privat në aeroporte, përmes pronësisë, menaxhimit ose programeve të reja investuese, mund të marrë forma të ndryshme, përfshirë edhe shitjen e plotë dhe të hapur të aksioneve ose asetëve, koncesionimet dhe qiratë afatgjata (Juan, 1996). Në Ekonomitë në Tranzicion qeveritë kanë preferuar koncesionimet më parë se shpronësimin (divesturën) e plotë, gjë që garantonte vazhdimësinë e pronës dhe të hyra të qëndrueshme nga kontratat e koncesionit. Koncesionimet e llojit 'Build Operate and Transfer' (BOT) (Ndërto, Opero, Transfero) kanë mbetur forma më e shpeshtë e pjesëmarrjes private në infrastrukturën aeroportuale në Ekonomitë në Tranzicion. Për dallim nga shitja ose koncesionimi permanent, qeveritë kështu mbanin një kontroll strategjik mbi projektin, kontroll i cili shpesh sjell edhe përfitime politike. Ky model u zbatua në Shqipëri³¹, Hungari dhe Turqi.

Sipas EBRD (2008), pjesëmarrja e sektorit privat në aeroportet e Ekonomive në Tranzicion ka mbetur relativisht e kufizuar. Përveç privatizimit të pjesshëm të aeroporteve në Rusi, Ekonomitë tjera në Tranzicion kanë zgjedhur llojin BOT të aranzhimeve koncesionare. Këto lloj projekte janë koncentruar në disa vende, përfshirë Armeninë, Hungarinë, Poloninë, Rusinë dhe Shqipërinë. Një aranzhim i tillë aktualisht është duke u zbatuar edhe në Maqedoni.

Kjo përvojë e limituar me privatizimin e aeroporteve, veçanërisht në Ekonomitë në Tran-

31 Shiko shtojcën 1 për analiza detaje

zicion, e bën të vështirë nxjerrjen e mësimave të qarta. Qartazi, qeveritë nuk do të jenë në gjendje të financojnë investimet e domosdoshme në infrastrukturën aeroportuale dhe prandaj pjesëmarrja e sektorit privat do të vazhdojë të mbetet esenciale dhe pjesë e pashmangshme, përveç sistemeve të kontrollit të trafikut ajror. Qeveritë do të vazhdojnë të përballen me sfidën e angazhimit të sektorit privat në këtë fushë të rëndësishme të aktivitetit dhe promovimin e një përfshirje aktive të këtij sektori.

3.4.2. Aktivitetet dhe Çështjet e ndërlidhura me Koncesionimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës (ANP)

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës është i vetmi aeroport ndërkombëtar në Republikën e Kosovës dhe mban monopolin mbi objektet e aeroportit. ANP gjendet rreth 15 km në jug-perëndim të kryeqytetit Prishtina. ANP ka vepruar nën administrimin e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit (AKM) deri në pavarësimin e Kosovës. Aktualisht, aeroporti është pronë dhe administrohet nga ANP, Sh.P.K, ndërmarrje kjo krejtësisht në pronësi të Qeverisë së Kosovës.

ANP ka një numër shumë të madh të udhëtarëve në raport me popullsinë dhe ky numër udhëtarësh po rritet vazhdimisht. Kjo është kryesisht rezultat i Diasporës së Madhe të Kosovës e cila e përdor ANP-në për fluturimet e saj. ANP ka më shumë se një milion udhëtarë, numër të cilin aeroporti e arriti dhe e tejkaloi vitin e kaluar. Gjithsej, në vitin 2008, ka pasur 1,137,000 udhëtarë civilë dhe rreth 100 mijë udhëtarë ushtarak. ANP është një nga aeroportet më të ngarkuara në Ballkan. ANP ofron shërbime aeroportuale si pranimi dhe përcjellja e aeroplanëve dhe udhëtarëve, depo kargo, ushqim, shitje e mallrave, si dhe kryen një sërë aktivitetesh tjera komerciale për shfrytëzuesit e aeroportit si huazimi i hapësirave për biznes, parking etj. Që nga viti 2009, ANP operon 24 orë në ditë duke ofruar shërbime non-stop. Vendimi u morr pasi shumë kompani shprehën interesim për të punuar 24 orë në ditë.

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës ka marrë një sërë mirënjohjesh për performancën dhe kushtet që ofron. Në vitin 2006, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës u shpërblye me the Best Airport 2006 Award (Aeroporti më i mirë në 2006), një nder ky i dhënë nga Airports Council International (ACI). Aeroportet fituese u përzgjedhën për shkëlqyeshmëri dhe arritje në një rang të gjerë kriteresh, përfshi edhe zhvillimin e aeroportit, operacionet, objektet, sigurinë dhe shërbimin për konsumatorë. Më vonë, aeroporti u përzgjedh nga kompania prestigjioze "British Airways", si 'golden station' (stacion i artë), në konkurrencë me shumë aeroporte tjera ndërkombëtare të shteteve të ndryshme.

Ka një numër të kompanive të mirënjohura botërore që operojnë në Kosovë, si: British Airways, Austrian Airlines, Malev, Swiss, Turkish Airlines, Hamburg International, Bell Air, Adria Airways, dhe Croatia Airlines. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës ishte aeroporti i parë në rajon që ofroi fluturime direkte për në SHBA. Gjatë vitit 2008, ANP arriti të shtojë të hyrat dhe të përmirësojë shërbimet. Në vitin 2009, ANP ka shënuar një rritje të shifrave sa i përket fluturimeve dhe udhëtarëve, me gjithë efektet negative që ka pasur kriza ekonomike globale. Në janar ka pasur një rritje

të udhëtarëve prej 6 përqind ndërsa gjatë shkurtit, prej 2 përqind. Fluturimet, gjatë këtyre dy muajve, në krahasim me vitin e kaluar janë shtuar për 15 përqind. ANP është një punëdhënës i madh publik. Punëson rreth 700 punëtorë. Në vitin 2008 ANP ka pasur një qarkullim prej rreth 25 milionë Euro, me një marzhë të profitit neto prej mbi 30 përqind. Kjo marzhë e lartë e profitit, e cila mund të jetë edhe më e lartë me një regjim më rigoroz të shpenzimeve, e bën ANP-në një destinacion tërheqës për investues potencial. Profiti i ANP-së kryesisht vjen nga taksat dhe ngarkesat aeronautike (rreth 89 përqind), ndërsa aktivitetet komerciale kontribuojnë me 11 përqind në totalin e të hyrave të ANP-së .

Drejtori menaxhues i ANP-së, i cili e parapëlqen pjesëmarrjen e sektorit privat, konfirmoi se kompani të mëdha po tregojnë interesim për të investuar në ANP. Ai shtoi se me investime të duhura, ANP mund të bëhet një qendër e rëndësishme në mes të Lindjes dhe Perëndimit. Sipas tij, ANP ka vazhduar me përpjekjet për ristrukturim me gjithë faktin se qeveria ka treguar përkushtimin e saj për prezantimin e pjesëmarrjes private. Sidoqoftë, ai thekson se punëtorët kanë frikë nga humbja e vendeve të punës, për të cilën ai mendon se nuk do të ndodhë duke marrë parasysh shkathtësitë specifike të cilat i posedon stafi dhe potencialin zhvillimor që posedon aeroporti në të ardhmen.

Me gjithë përmirësimet operacionale, si ato në reduktimin e kohës për menaxhimin e aeroplanëve, menaxhimin e bagazhit, punës në kushte të vështira klimatike, ANP ka prezantuar edhe pako stimuluese për kompanitë ajrore për të përmirësuar edhe më tutje aeroportin

Ndërsa është evidente se ANP mund të funksionojë në mënyrë adekuate si një ndërmarrje me pronësi dhe në administrim publik, Qeveria e Kosovës po kërkon që aeroporti të përmbushë gjithë potencialin e tij ekonomik dhe operacional. Prandaj, me 12 qershor 2009, Qeveria e Kosovës, me vendimin e saj numër 05/68, formalisht autorizoi fillimin e procedurave për Partneritetin Publiko-Privat për menaxhimin dhe zgjerimin e ANP-së. Në një intervistë me ekipin hulumtues, Ministri i Transportit, Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës, Fatmir Limaj, shfaqti përkushtimin për të proceduar shpejtë me këtë proces. Sipas tij, niveli i investimeve pritet të jetë rreth 85.6 milionë euro. Ndërsa procesi i prokurimit deri në dhënien e kontratës, bazuar në një proces prokurues konkurrues dhe ndërkombëtar, pritet të përfundojë në dhjetor 2009, struktura e pritur e transaksionit përfshinë, mes tjerash; struktura e kontratës do të jetë Design Build Finance Operate Transfer (DBFOT) (Dizajno-Ndërto-Finaco-Opero-Transfero), ndërsa kohëzgjatja 20 vjet. Përveç Shërbimeve të Navigacionit Ajror, të gjitha shërbimet tjera do të jenë lëndë e kësaj kontrate. Tarifa koncesionare do të paguhet në formë të përqindjes së të hyrave bruto, ndërsa ngarkesat dhe tarifat aeronautike do të fiksohen në nivelet aktuale, përgjatë kohëzgjatjes së kontratës, me mundësi ndryshimi si rezultat i inflacionit, por me miratimin paraprak të rregullatorit. Sa i përket të punësuarve aktualë, operatori privat duhet të respektojë kontratat aktuale të të punësuarve, për një periudhë të përcaktuar kohore. Ne konsiderojmë se kjo pikë mund të dekurajojë investuesit ose do të reflektohet në kushtet e ofruara nga investuesit potencial, sepse ANP në këtë moment ka staf të tepërt. ANP ka mbi 700 punëtorë, ndërsa Aeroporti i Tiranës, që shërben një numër të ngjashëm të udhëtarëve ka tejkalluar numrin 300 të të punësuarve vetëm sivjet. Kontrata e koncesionimit po ashtu parasheh edhe një plan të investimeve minimale të domosdoshme³². Rezultati i marrëveshjes së koncesionimit pritet të modernizojë Aeroportin duke mbajtur hapin me konkurrentët tjerë në rajon.

32 vizito www.pppkosova.org për një përmbledhje të gjerë lidhur me strukturën e transaksionit për Koncesionimin e ANP-së.

4. PËRMBLEDHJE E KONKLUZIONEVE:

- (1) Korniza ligjore ofron vetëm zgjidhje bazike për fillimin e privatizimit të NP-ve. Procedurat dhe politikat nuk janë të qarta. Duket se Komitetit Qeveritar për Privatizim (KQP) dhe Komitetit Drejtues Ndërmarrës për Partneritetin Publiko-Privat (PPP-KNM) i janë dhënë tepër shumë fuqi e autorizime, pa siguruar një linjë të qartë të mbikëqyrjes dhe raportimit drejtë Kuvendit të Kosovës. Kjo nënkupton që korniza ligjore duhet të kompletohet në një të ardhme të afërt duke amenduar ligjin në fuqi për NP-të dhe ligjin për PPP dhe Koncesionime, ose duke nxjerrë ligje për privatizimin e secilës nga NP-të e mëdha: KEK, PTK dhe ANP;
- (2) Qeveria nuk ka ndërtuar politika të qarta në lidhje me ristrukturimin e strukturës pronësore të NP-ve, pas rëndësive të parë të privatizimit, respektivisht, nëse do të shesë të gjitha aksionet tek sektori privat, apo do të mbajë një pjesë në pronësi publike. Duke marrë parasysh përvojat tjera, do të mund të konsiderohej një zgjidhje ku një pjesë e aksioneve të mbesin në pronësi publike, por në një përqindje të tillë që nuk do të ishte dekurajuese për investitorët strategjikë. Kjo duhet të përcaktohet pas një studimi të kujdesshëm të tregut dhe një studimi të fizibilitetit, që do të duhej të mbështesnin vendimet qeveritare. Përvojat kanë treguar se këto aksione do të mund të shiteshin në një rund të ri privatizimi me çmim shumë më të lartë në krahasim me ato të rundit të parë. Po ashtu, nuk ka një politikë të qartë qeveritare në lidhje me të ashtuquajturën "golden share" – aksion i artë. Aksioni i artë, si i tillë, është paraqitur para 25 vjetësh (për British Petroleum dhe disa kompani tjera) kur qeveria nuk ishte e sigurt se si të vazhdojë me privatizimin dhe se çfarë do të ndodhë me kompanitë në pronësi private. Ideja e aksionit të artë ishte t'ia mundësojë qeverisë të ndërhyjë në situata strategjike si mbyllja e kompanisë, ose blerja e saj nga një blerës i jashtëm i padëshirueshëm. Përparësia mbetet e njëjtë, për disa ekonomi në tranzicion, duke i dhënë qeverisë shans për të intervenuar në vendimet në lidhje me çështjet me rëndësi kombëtare. Disavantazhi i saj është se mund të përdoret për qëllime e presione politike, duke ndikuar në kompanitë investitore që të punojë në favor të një partie ose grupi politik.
- (3) Qeveria e Kosovës ka treguar qartë përkushtimin e saj për një privatizim energjik dhe të shpejtë, të të tri NP-ve strategjike. Ndonëse kjo vendosmëri duhet të vlerësohet pozitivisht, duket se ajo është në shpërpjesëtim të dukshëm me nivelin aktual të përgatitjeve, krijimin e një kornize ligjore solide, krijimin e përkrahjes së domosdoshme publike dhe politike dhe konsensusin themelor në Kuvend, dhe me aktorët tjerë kyç në shoqëri. Një situatë e tillë dëshmohej si një ambient që nuk përkrahë qëllimet e qeverisë dhe kjo po provohet edhe nga mungesa e progresit përmbajtësor gjatë më shumë se 18 muajve të fundit, qysh se qëllimet e qeverisë u bënë publike.
- (4) Duket se Qeveria mbështetet kryesisht në këshilltarët e transaksionit sa i përket politikave, procedurave dhe modeleve. Kjo mund të jetë pozitive deri në një masë dhe për aq sa nuk e pengon transparencën dhe debatin publik në Kuvend, në qarqe akademike dhe në shoqërinë civile. Ne do të sugjerorim që studimet e fizibiliteti për PTK-në, Distribucionin dhe Furnizimin e KEK-ut, Termocentralin Kosova B të përgatiten për të mbështetur politikat qeveritare dhe për të fuqizuar pozicionin e saj negociues.

- (5) Qeveria nuk ka një politikë funksionale sa i përket përdorimit të të ardhura (fondeve) nga privatizimi i NP-ve. Aspekte kyçe të kësaj çështjeje duhet të debatohen në shoqëri: në Kuvend, në mesin e akademikëve, dhe shoqërisë civile. Pasi që këto korporata janë për të shërbyer për interesin publik në përgjithësi, për gjeneratat aktuale dhe ato të ardhshmet, ne konsiderojmë se një pjesë e madhe e këtyre fondeve, pas shlyerjes së kostos së transaksionit, do të duhej të përdroreshin për investime publike në infrastrukturë, arsim dhe shëndetësi dhe jo për konsum aktual buxhetor përkatësisht për rroga, mallra dhe shërbime.

SHTOJCAT

Shtojca 1:

Privatizimi i sektorit strategjik në Shqipëri (Rastet e Albtelecom, Aeroporti Nënë Tereza, dhe OSSH të Korporatës Energjetike KESH)

Nga: Entela Shehaj³³ - Enti rregullator shqiptar për energji

Strategic Sector privatisation in Albania

Privatizimi në përgjithësi si dhe privatizimi i ndërmarrjeve që i takojnë shtetit ishte një nga elementet kyçe në procesin reformues në Shqipëri që ndihmon ta qoj ekonominë nga ekonomia e planifikuara në atë të sistemet e tregut. Ligji nr. 7512 "Mbi sanksionet dhe mbrojtjet e pronës private" aprovoi dhe solli mbrojtje ligjore për pronat private, investime të jashtme, legalizoi marrjen private në punë të punëtorëve, dhe lejoi privatizimin e pronës shtetërore. Deri në vitin 1997 procesi i privatizimit ishte i rregulluar nga Vendimet e Këshillit të Ministrave (VKM). Duke marrë parasysh rëndësinë e sektorit strategjik, pas kësaj Qeveria përgatiti një strategji ku privatizimi iu nënshtrua ligjeve. Strategjia e privatizimit "Strategjia për privatizimin e sektorëve me rëndësi të veçantë" u aprovua nga Ligji nr. 8306 në mars të 1998. Bazuar në këtë strategji, çdo kompani publike duhet të privatizohet sipas Ligjit përkatës. Sektorët strategjike janë: sektori i energjisë, i minierave, i gazit dhe naftës, postës, telekomunikimit, rezervave të pyjeve dhe ujërave, transporteve hekurudhore, limaneve, aeroporteve dhe transportit ajror në përgjithësi, si dhe bankat dhe kompanitë e sigurimeve të dorës së dytë si pronë shtetërore. Sipas Ligjit nr. 8306, 1998, një investitor strategjik është një person ligjor i cili mban garanci financiare dhe i cili është i licencuar për aktivitete ekonomike në një sektor special, dhe jo më shumë se 30% e aksioneve të kompanive iu afrohen atyre që t'i privatizojnë.

Rekonsruktimi dhe privatizimi i këtyre sektorëve ka nevojë për një investim të madh që mund të mbajë vetëm investitorë strategjikë. Institucionet ndërkombëtare siç janë Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore kanë monitoruar dhe mbikëqyrur procesin e privatizimit strategjik në Shqipëri. Në mënyrë që të bëhen këta sektorë më atraktivë, kompanitë iu nënshtruan rishtrukturimeve para privatizimit. Ato kompani u bënë shoqëri aksionare dhe disa nga ato (posaçërisht ato të integruara vertikalisht) u kthyen në njësi më të vogla.

Komiteti për Konsultime dhe Transparencë (i krijuar në shtator 1998 nga VKM No.21) kishte për detyrë të drejtonte, mbikëqyrte dhe monitoronte procesin e privatizimit. Ky Komitet drejtohej nga Ministria e Marrëdhënieve Publike dhe Privatizimeve (Ministria e Ekonomisë sipas amendamentit të CMD nr. 621 në janar 2002) dhe përfshin reprezentues nga Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, ministritë e linjës,

33 Përmbajtja e kësaj pjese është përgjegjësi e plotë e autorit dhe nuk përfaqëson qëndrimin e institucionit prej nga vjen.

qeveritë lokale si dhe konsultimet dhe donacionet e huaja.

Qëllimi kryesor i privatizimit në shtetet e zhvilluara ishte që të përmirësohet efikasiteti i një kompanie. Në Shqipëri, kjo situatë ishte më komplekse sepse privatizimi bëhej kryesisht që të lehtësohej transformimi nga ekonomia e planifikuar në ekonomi të tregut. Përveç efikasitetit të kompanisë, qëllimet e tjera ishin edhe tërheqja e investimeve të reja, ulja e shpenzimeve buxhetore (ulja e të ardhurave shtetërore për kompanitë që humbin para), rritja e efikasitetit të sistemit të tregut dhe krijimi i kushteve për një treg kapital dhe krijimi i vendeve të reja të punës. Tërheqja e investimeve të huaja ishte një nga objektivat kryesorë gjatë privatizimit, por kjo objektivë u bë qëllim kryesor gjatë kësaj procedure të privatizimit strategjik.

Në pjesët e mëposhtme kemi renditur tri raste të privatizimit strategjik në Shqipëri. Këto raste të detajuara janë privatizimi i Aeroportit "Nënë Tereza", Albtelekomit, dhe Korporatës Elektro-Energjetike të Shqipërisë (KESH).

Privatizimi i Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza"

Njësia e Aeroportit Ndërkombëtare të Tiranës daton që nga kohët socialiste të viteve 1955-1957, por në atë kohë deri në vitet e 80-a nuk kishte numër të mardh fluturimesh ditore. Numri i fluturimeve dhe kompanive operuese filloi ngritje gjatë viteve të 90-a. Ballafaquar me nevojën për përmirësim dhe rregullim tërësor të Aeroportit, nga viti 2002 Qeveria vendosi të paraqesë ftesën tek investitorët ndërkombëtarë për ndërtimin e një terminali të ri dhe operimin e aeroportit. Procedura e tenderit për koncesion të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës filloi më 17 dhjetor 2002 dhe vazhdoi deri në vitin 2003. Fituesi u shpall në janar të vitit 2004, një konsorcium i tre kompanive³⁴, kjo marrëveshje u nënshkrua më 15 tetor të vitit 2004 në mes të Qeverisë shqiptare dhe fituesve.

Ligji nr. 7973 "Mbi Koncesionin dhe Pjesëmarrjen e Sektorit Privat në Shërbimet Publike dhe Infrastrukturë" në korrik të vitit 1995 lejoi koncesionin e Aeroportit të Tiranës. Ky ligj pati për qëllim krijimin e një pasqyre legale për pjesëmarrësit e sektorit privat (nacionalë dhe internacionalë) përmes koncesionit dhe përmes formave të tjera të partneriteteve shtetërore-private në shërbime publike dhe infrastrukturë. Ky ligj u përmirësua 6 herë, duke filluar me përmirësimin e parë në mars 1996, dhe të fundit në shkurt të vitit 2005. Në dhjetor 2006 ky Ligj u shfuqizua nga Ligji nr. 9662, megjithatë, procesi i privatizimit të Aeroportit Ndërkombëtarë të Tiranës u udhëhoq nga disa vendime të Këshillit të Ministrave. Përmes VKM-sw u aprovua plani dhe studimi i fizibilitetit për koncesionin e ndërtesës së terminalit të ri të Aeroportit të Rinasit, u vendos Njësia Shtetërore Autorizuese për përgatitjen dhe realizimin e kontratës së koncesionit, u vendos për trajtimin e punëtorëve që humbën vendet e punës gjatë ristrukturimit të Albrtransportit, u aprovua Garancia e Marrëveshjes për fituesit e tenderit mes Republikës së Shqipërisë dhe EBRD për kredinë e dhënë partnerëve të Aeroportit të Tiranës (PAT) nga EBRD. Ishte CMD nr 479 e gushtit të vitit 2000 që lajmëroi se filloi procedura e tenderit për ndërtimin e terminalit të ri me koncesion të tipit BOOT. Ky ishte tender ndërkombëtar me dy

34 Aksionarët e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës u bënë HOCHTIEF AirPort GmbH (Hta), Deutsche Investitions und Entwicklungs-gesellschaft (DEG) dhe Fondi Ndërmarrës Amerikano-Shqiptar (AAEF)

faza (e para e parakualifikimeve). U vendos që një këshilltar internacional t'i realizojë procedurat e ndërtimit të terminalit të ri me koncesion të tipit BOOT.

Marrëveshja e Koncesionit u ratifikua nga parlamenti përmes Ligjit nr 9312 në nëntor të vitit 2004. Ky ligj i dha kompanisë të drejtën të përjashtohet nga taksat doganore dhe taksat mbi vlerën e shtuar (TVSH) gjatë periudhës së ndërtimit të terminalit të ri dhe për zgjerimin e fushës fluturuese dhe rrugës për në Aeroport.

Marrëveshja e koncesionit përmbante 38 artikuj dhe 70 shtesa, për secilin qëllim të këtij prezantimi unë do të diskutoj pikat kryesore të kontratës. Koncesionit iu dhanë 20 vjet dhe gjatë kësaj periudhe asnjë Aeroport s'do të ketë të drejtën e fluturimeve komerciale dhe ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë (përveç aterrimeve urgjente). Lidhur me pagesën ndaj Qeverisë së Shqipërisë, koncesioni i parë pagoi 3 milionë euro. Shteti shqiptar do të marrë 30% të profitit vjetor të kompanisë³⁵. Vlerat e pritura të këtyre pagesave janë dhënë në shtesën nr 43 të marrëveshjes së koncesionit. Kompania ka si obligim pagesën ndaj shtetit shqiptar për të gjitha kreditë gjatë kohës së koncesionit.

Marrëveshja detajizon plan programin për ndërtimin dhe realizimin e terminalit të ri. Sipas orarit planifikues, kompania kishte 386 ditë kohë për të konstruktuar këtë terminal. Gjatë fazës A të ndërtimit të terminalit dhe para fillimit të fazës B, kompania obligohet të ballafaqohet me së paku 1 milion pasagjerë për një vit. Kompania ka respektuar afatet e vendosura në marrëveshje dhe në maj të vitit 2007 u inaugurua terminali i ri, dhe në shtator të po atij viti u inaugurua pjesa shtesë (faza B e

Privatizimi i AlbTelekomit

Telekomi ka qenë pjesë e Post-Telekomit Shqiptar deri në vitin 1992. Në vitin 1992 Telekomi Shqiptar u themelua si kompani e veçantë nga Albtelekomi (Shoqëri akcionare) me 100% fonde kapitale në shkurt 1999. Si me sektorët e tjerë strategjikë, Ligji nr 8306 në mars 1998 hapi udhën për privatizimin e Albtelekomit. Në qershor të vitit 1999 (me VKM nr 288 u mor një vendim që u modifikua 4 herë deri në korrik 2003) shteti aprovoi dhe dokumentoi Politikën Zhvilluese të Telekomunikacionit të Republikës së Shqipërisë. Ky dokument ka një pjesë të veçantë mbi privatizimin e Albtelekomit dhe thekson se privatizimi i Albtelekomit planifikohet në vitin 2001. Po ashtu aty u vendosën edhe disa objektiva të tjera (siç janë zgjerimi i rrjetit kombëtar dhe përmbushja e nevojave për koneksione të reja, shpejtim në modernizimin e rrjetit infrastrukturor, etj.) për investitor strategjia në shkëmbim me ekskluzivitetin e shërbimeve telefonike gjër më 31 dhjetor të vitit 2004. Qeveria vendosi që Albtelekomi t'i ofrohet investonit strategjik së bashku me licencën për shërbime GSM. Po ashtu, u theksua që operatorët do të kenë monopoli dhe do të jenë nën ndikimin e tarifave dhe rregulloreve të bazuara në mekanizmin e çmimit tavan.

Ishte Ligji nr. 8810 në maj të vitit 2001 që vendosi format dhe formulat e privatizimit të Albtelekomit. Jo më shumë se 51% dhe jo më shumë se 76% të aksioneve të Albtelekomit u vendos të transferoheshin tek investitorët strategjikë në një tender të hapur internacional. Ndaras nga 3% i aksioneve u vendon të transferoheshin në Albapost dhe ato që mbetën u transferuan te pronarët e tokave dhe ndërtesave si

³⁵ Pritej që nga koha e koncesionit, Qeveria shqiptare përveç pagesës së parë do t'i marrë edhe 44,077,00 milionë euro.

dhe te punëtorët e Albtelekomit. Në korrik të vitit 2004 Qeveria përmes VKM 416 vendosi që 76% të Albtelekomit t'u ofrohet investitorëve strategjikë. Pjesë e kësaj pakete ishte edhe shërbimi GSM (Eagle Mobile).

Pas shpalljes së tenderit për shitjen e 76% të Albtelekomit, CETEL shpallet si fitues me VKM nr. 359 në maj 2005 dhe kontrata u nënshkrua më 23 qershor 2005. Për shkak të mospërmbushjes së kriterëve dhe kushteve të pritura të Marrëveshjes për Blerje të Aksioneve (MBA), transaksionet mbyllëse të MBA nuk u finalizuan. Shteti shqiptar, përmes VKM nr. 7 në tetor të 2005 kërkoi ekspertizë ndërkombëtare për formën e MBA dhe vlerësimin e procedurës së procesit të privatizimit. Në qershor të vitit 2007, CETEL kishte obligim në partneritet me Turk Telekomunikasyon A.S. ku ky i fundit do të jetë pronar i jo më pak se 20% të aksioneve.

Mes blerësve të tjerë në kontratë vlen të përmendet se nëse pas 5 vjetëve blerësi nuk mbërrin 80% e vlerës së investimeve të llogaritura në planin e biznesit, atëherë blerësi i paguan shitësit 20% të vlerës së përealizueshme të investimeve për çdo vit. Në rast se 5 vjet pas mbylljes së kontratës, blerësi arrin së paku 80% të këtyre investimeve të parashikuara në biznes plan atëherë blerësi do t'i paguajë shitësin 2% të vlerës së përealizueshme të investimeve për çdo vit.

-Destinimi i fondeve

Ligji nr. 8810 shpjegon përdorësinë e privatizimit në artikullin numër katër. Bazuar në këtë ligj, të ardhurat e privatizimit të Albtelekomit do të përdoren për mbulimin e shpenzimeve të organizimit të tenderit, pagesës së faturës për konsulent ndërkombëtarë, dhe të punëtorëve. Pjesa tjetër e mbetur do të shkojë në buxhet shtetëror. Bazuar në formulë, 50% e të ardhurave do të ulin borxhin shtetëror dhe të tjerat do të përdoren për projekte investuese.

Privatizimi i OSSH të Korporatës Energjetike të Shqipërisë (KESH)

Biznesi i distribuimit në Shqipëri bënte pjesë në mënyrë vertikale të integritit në KESH. Deri në dhjetor të vitit 2006. Ndarja e divizionit të distribuimit nga KESH-i dhe ndarja e sistemit operativ të distribuimit u aprovua në dhjetor të vitit 2006 nga VKM nr. 862 "Për vendosjen e kompanisë OSSH ShA" me 30 maj 2007, Bordi kujdesës i KESH-it vendosi për krijimin e OSSH më 19 korrik 2007 i regjistruar në Gjykatën Komunale të Tiranës.

Korporata Financiare Ndërkombëtare u zgjodh si konsulente në asistimin e Qeverisë gjatë procesit të ristrukturimit dhe privatizimit të OSSH-së. Pas due-diligence process dhe KFN vendosën raportet rekomanduese Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, KESH-it dhe Rregullatorit Energjik Shqiptar (AER) në detyrat që duhet përmbushur gjatë privatizimit.

AER-i pati obligim që për Qeverinë të bëjë përgatitjen dhe dorëzimin për modelin e ri të tregut shqiptar (MTSH), si dhe të rishqyrtojë të gjitha legjislacionet dytësore që t'i bëjë të krahasueshme me MTSH-n e re. MTSH-ja u aprovua nga Qeveria në mars të vitit 2008. Bazuar në MTSH, OSSH do të performojë dy aktivitete kryesore: distribuimin (mirëmbajtja, rritja, operimi i sistemit të distribuimit në territorin shqiptar) dhe Retail Public Supplier activity (shitja e elektricitetit te konsumatorët tarifues). Kjo formë e formuluar për privatizimin e OSSH u definuan nga Ligji nr. 9889 në

mars të vitit 2008. Bazuar në këtë ligj, forma e privatizimit ishte një tender i hapur internacional me parakualifikime frazore dhe jo më shumë se 51% dhe jo më shumë se 71% të aksioneve do t'u ofroheshin investitorëve strategjikë. Pjesët e tjera do t'u ofroheshin pronarëve të mëparshëm dhe punëtorëve të mëparshëm të OSSH.

Faza parakualifikuese në maj të vitit 2008 lajmëroi që 4 kompani ishin parakualifikuar. Sipas ligjit të lartpërmendur, proceduara e vlerësimit të ofertës dhe kriteret e seleksionimit të fituesve për privatizimin e OSSH do të definoreshin me VKM. Në qershor 2008, VKM nr 835 vendosi që 76% të aksioneve të kompanisë të ofroheshin për privatizim, dhe të bashkangjitura si aneks kishte instruksione mbi realizimin e këtij privatizimi. Tenderi u hap më 29 shtator 2008 dhe nga 34 të parakualifikuarit vetëm 2 e vendosën ofertën. Pas një muaji Qeveria shpalli fituesin e tenderit (CEZ). Negociatat mes fituesit dhe shtetit shqiptar për Marrëveshjen e Blerjes së Aksioneve (MBA) dhe Rregullatorëve (që ishin pjesë e aneksit), filluan në nëntor 2008 dhe përfunduan në mars 2009.

Ka edhe dokumente të tjera të rëndësishme të lidhura me privatizimin e OSSH, Marrëveshja mbi Mbështetjen e Qeverisë (mes Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë, dhe Energjisë dhe OSSH), dhe Garancia për Risk Pjesor (mes Qeverisë së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rikonstruktim dhe Zhvillim). Të dy dokumentet kishin lidhje me njëra-tjetrën. Garancia për Risk Pjesor e IBRD ishte që të mbulonte risqet e lidhura me aktivitetet e OSSH si kompani private. Ministria e Financave (garantuesi), Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë (Pjesa e mbështetjes teknik) dhe beneficiari (OSSH) u kërkohet të hyjnë në GSA. Të dy dokumentet u aprovuan nga Parlamenti në maj të viti 2009, dhe i tërë procesi përfundoi më 29 maj 2009.

SPA u ratifikua nga Parlamenti në fund të prillit dhe siç u përmend në Rregullativa, u fut në SPA. Por, në Rregullativa (RS) kishte një element kritik për gjithë procesin e privatizimit. RS përfshin 3 periudha rregullative duke filluar nga 2014 dhe kishte për qëllim kalkulimin e tarifave e të gjitha formave përdoruese: përdoruesve publikë, distribuimit, etj. Bazuar në AMM Wholesale Public Supplier blen elektricitet nga gjeneratorët publikë, prodhuesit e tjerë të vegjël dhe importon dhe shet këtë miks të Retail Public Suppliers me një çmim të rregulluar.

Kompania distribuese operon në baza të cap price formula dhe faktori X vendoset në zero për 3 periudha rregullative. Kalkulimi i mesatares është element kyç për RS. Supozohet se tarifa do të jetë 60% borxhe dhe 40% pronë. ROE fiksohet në 16.44% për tri pjesët rregullative. Bazuar në çmimin e borxhit, nuk kemi të dhëna të dërguara nga RS, por nga ERE për të kalkuluar mesataren e çmimit për kapital, kjo u gjend në mënyrë transparente gjatë procedurës së tenderit

Edhe pse u bënë përpjekje për të ulur humbjet, niveli i rrjetit distribuiv ishte i lartë për një periudhë të gjatë kohore. Sipas AMM, kompania distribuese do të blejë energji që të mbulojë shpenzimet në tregun e lirë dhe jo për të rregulluar çmimet, përndryshe kompania do të ketë incentiva të ulëta për t'i ulur ato. Niveli i humbjeve në rrjetin e distribuimit në vitin 2008 ishte 32.7% e elektricitetit të futur në rrjet. Divizioni i kësaj figure në humbje teknike dhe jo teknike dhënë nga kompania vendos nivelin përkatës për humbje teknike. Ky studim, bazuar nga RS, do të bëhet nga AER-i për aprovim. Meqenëse humbjet janë pjesë e tarifës së elektricitetit, AER-i ka vendosur si qëllim uljen e humbjeve gjatë këtyre 3 periudhave 4% ulje gjatë dy

periudhave dhe 9% gjatë asaj të fundit. Total 17% ulje janë qëllimet deri në vitin 2014. Kompania do të ketë benefit nga çdo mbi-punë në uljen e humbjeve dhe do të bëjë çdo kosto të mungesës së punës.

Kreditë e këqija dhe kreditorët e këqij me asnjë shpresë të kolektivit janë një temë me shumë rëndësi për kompaninë. U negociua që për tarifën e parë të aplikacionit nivel i 14% të RPS revenu, i kredisë së keqe të përfshihet në tarifë. Por, kompania do të bëjë studime që ta definojë qartë nivelin e kredisë dhe rezultati i këtij studimi do të aprovohet nga ARE. Nëse tregohet një nivel i lartë i kredisë më lartë se 14% kompania do të kompensohet në vitet përkatëse, dhe anasjelltas. RS-ja ka cak edhe uljen e kredisë së keqe gjatë 3 periudhave rregullative të para. Të dyja humbjet dhe kreditë e këqija kontribuojnë në performanca të këqija financiare të OSSH. Pritet që të përmirësohen këto humbje dhe kreditë të nivelohen dhe të kenë fuqi të uljes për tarifën e ardhshme.

Pjesë tjetër me rëndësi e RS është kompensimi i mekanizmit. U negociua që mesatarja e përdoruesit final të rritet me 15% në terme reale, me minimum tarifor mesatar 15%. Porcioni i kërkuar nga të ardhurat që nuk u morën parasysh në vitet përkatëse do të kompensohet. Kompania ka të drejtë mbi këto shuma përmes këtij mekanizmi tarifor e elektricitetit do të ngritën në masa të vogla.

Ligji nr. 9889 i përmendur më lartë, në artikullin 5 përfshin edhe përdorimin e të ardhurave nga privatizimi. Bazuar në këtë ligj të ardhurat e privatizimit të OSSH do të përdoren për mbulimin e shpenzimeve të organizimit të procedurës së tenderit, pagesës së konsulentëve nga METE dhe pagesës dhe rrogat e punëtorëve që dolën në pension gjatë ristrukturimit të OSSH. Pjesa tjetër do të shkojë në buxhetin e shtetit. E njëjta formulë e përdorur në rastin e Albtelekomit është përdorur për përdorimin e të hyrave nga shitja e OSSH-së.

Përfundimi

Duke pasur parasysh rëndësinë e sektorëve strategjik, një vëmendje e veçantë i është kushtuar përgatitjes së këtyre ndërmarrjeve për t'u privatizuar; ligjet dhe legjislacioni sekondar si dhe përfshirja e institucioneve dhe konsulentëve ndërkombëtarë. Për shkak të rëndësisë dhe gjendjes specifike të secilës prej këtyre ndërmarrjeve që duheshin privatizuar, procedurat e privatizimit të këtyre kompanive në disa raste kanë zgjatur edhe me vite. Privatizimi i Albtelekomit, siç është diskutuar në seksionin 3 të këtij punimi, ka zgjatur afërsisht 6 vite për tu kompletuar.

Tre shembujt e marrë në këtë artikull janë nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe si rrjedhojë ka dallime në procesin e gjithëmbarshtëm të privatizimit të tyre. Përkundër dallimeve, disa çështje kanë pasur trajtim të ngjashëm në të tria rastet. Metoda e përdorur për privatizimin e Albtelekomit dhe OSSH-së ka qenë përmes tenderimit ndërkombëtarë ku 76% e aksioneve ju ofruan investitorëve strategjik. Në rastin e aeroportit është përdorur kontratë koncesionale e llojit BOOT (ndërto, posedo, opero dhe transfero). Një element i rëndësishëm në procesin e privatizimit të dy ndërmarrjeve është ekskluziviteti që i është dhënë investitorit strategjik. Në rastin e aeroportit, koncesionari ka të drejtën ekskluzive përgjatë gjithë periudhës së koncesionit. Është vendosur që i gjithë territori i Shqipërisë të jetë një zonë shpërndarëse dhe kjo i është dhënë një investitori strategjik që ka privatizuar dis-

tribuimin e rrymës elektrike (OSSH). Në rastin e privatizimit të Albtelekomit, është paraparë që investitori strategjik të ketë të drejta ekskluzive për një periudhë të caktuar. Mirëpo pasi që privatizimi është zgjatur më shumë siç është pritur, vetëm Albtelekom si kompani shtetërore ka përfituar nga këto të drejta ekskluzive. Në të tria rastet, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve do të zgjidhet në gjyqin e arbitrazhit në Vjenë.

Shtojca 2:

Privatizimi i sektorit strategjik në Maqedoni

Rasti i shpërndarjes së energjisë, telekomit maqedonas dhe i koncesionit të aero-porteve.

Nga: Hyrije Abazi³⁶ - Universiteti i Evropës Juglindore

Hyrje

Qëllimi i këtij raporti është që të japë një pasqyrë të përgjithshme të procesit të privatizimit të disa ndërmarrjeve të rëndësishme publike kombëtare (të referuara si 'ndërmarrje strategjike') në Republikën e Maqedonisë. Në detaje, ne do të diskutojmë procesin e privatizimit në sektorët e energjisë dhe telekomunikimit si dhe koncesionin e aeroportit. Në lidhje me këtë do të elaborohen çështjet e kornizës ligjore, procesi i privatizimit dhe modelet që janë zbatuar si dhe destinomi i fondeve pas privatizimit të kompanive.

Gjendja e procesit të privatizimit në sektorin e energjisë

Në fund të nëntorit të vitit 2002, Qeveria e Republikës së Maqedonisë i dha përgjegjësinë Ministrisë së Ekonomisë së bashku me "Electrostopanstvo na Makedonija"(ESM) si dhe institucioneve të tjera të përfshira, në bashkëpunim me konsulentët e Qeverisë, për reformimin e AD ESM në mënyrë që të vazhdohet me realizimin e aktiviteteve në pajtim me detyrat e projektit dhe me konsulentët. Me specifikim të karakteristikave themelore të modelit të tregut, adoptimin e Parimeve të Direktivave Evropiane 2003/54/EC përmes specifikimeve të definuara gjatë nënshkrimit të memorandumit të Athinës në vitet 2002 dhe 2003, dhe me adoptimin e modelit të ristrukturimit të ESM-së të përgatitur nga konsulentët, ishte edhe nevoja e përgatitjes së kornizës ligjore për implementimin e një strukture të re të sektorin energjetik në RM. Më 19.03.2004 Parlamenti sjelli Ligjin për reformimin e ESM Maqedonia, korporata për prodhim, transmisioni dhe shpërndarje të energjisë elektrike me pronësi shtetërore. Artikulli 1 dhe 2 i ligjit definojnë objektivin që është arritur përmes ligjit – ristrukturimi dhe privatizimi i ESM-së. Artikulli 3 definojnë këtë ligj si të natyrës Lex Specialis në raport me ligjin për kompanitë. Artikujt 4, 5, dhe 6 rregullojnë ristrukturimin e ESM-së duke ndarë atë në dy korporata me pronësi shtetërore., së bashku me sektorin e aseteve, punëdhënësve, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë si në vijim:

1. AD-së për prodhim, shpërndarje dhe furnizim me energji elektrike ("ESM"), dhe
2. AD-së për transmision të energjisë elektrike dhe menaxhim të sistemit elektro-energjetik ("MEPSO")

Artikulli 7 definojnë kushtet me të cilat ESM AD mund të privatizohet (por jo edhe "MEPSO" AD) dhe/ose të korporatave të krijuara nga ato, duke shitur pjesë ose të gjitha aksionet në një apo më shume transaksione, tek investitori (pronar vendor apo i jashtëm, apo institucion financiar ndërkombëtar me pronësi të shumta

³⁶ Përmbajtja e kësaj pjese është përgjegjësi e plotë e autorit dhe nuk përfaqëson qëndrimin e institucionit prej nga vjen.

shtetërore ku Maqedonia është anëtare):

1. Duke nënshkruar shitjen e kontratës në aksione të vogla me institucione ndërkombëtare financiare, dhe/apo
2. Përmes ftesës publike në të cilën para-kualifikimi është i përfshirë, në pajtim me rregullat e caktuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, apo
3. Në mënyra të tjera të përcaktuara me ligj.

- Strategjitë e privatizimit

Konsulenti përgatiti një propozim të strategjisë së privatizimit si dhe dha vlerësimin e parë. Nga këto strategji, disa këshilla dhe konkluzione janë dhënë për kuptimin e procesit të privatizimit të ESM AD-së: i) lidhur me metodën e privatizimit, këshillohet që të ofrohen aksione të ESM AD-së përmes një apo dy (në të njëjtën kohë) ftesave publike ndërkombëtare, ii) lidhur me investitorët potencialë është sugjeruar që privatizimi të kryhet nëpërmjet shitjes së aksioneve një investitori dominues dhe strategjik ndërkombëtar, apo një shoqërie aksionare e investitorëve strategjikë financiarë (përfshirë pjesët e aksioneve të shitura më parë te EBRD); iii) lidhur me përqindjet e pronarit dominues, sugjerohet që t'i jepen 51% e pronësisë pronarit dominues. Pasi këto sugjerime të konsulentit ishin marrë në konsideratë nga qeveria, komisioni konkludoi që privatizimi mund të realizohet duke shitur aksionet tek investitori strategjik:

1. Sole, ndërmarrje e integruar vertikalisht;
2. Ndërmarrje, aksionet e së cilës mbahen nga të dyja ndërmarrjet (to sole investor)
3. Cilado nga dy kompanitë në mënyrë individuale.

Sipas vendimit të nxjerrë, privatizimi do të realizohet përmes shitjes së paku 51% të aksioneve të ESM AD-së nëpërmjet ftesës publike të një investitor i huaj.

Më 16.05.2005 Qeveria përkrahu procesin e privatizimit dhe i dha obligim ESM AD-së që të administrojë ristrukturimin në dy kompanitë e sipërpërmendura. Pas ristrukturimit në vitin 2005, territori i prodhimit të energjisë është i mbuluar nga kompania shtetërore ELEM dhe një termocentrali me djegie të naftës prej 210 MW – Negotino.

Privatizimi në sektorin e energjisë mori një hap të madh në mars të vitit 2006 me privatizimin e 90% të aksioneve në kompaninë kombëtare të distribucionit "Electrostopanstvo na Makedonija" (ESM) të shërbimet publike Austriake EVN AG. Pjesa e mbetur e aksioneve (10%) të mbeten pronësi shtetërore për tani. Gjatë parprivatizimit të ESM-së, që nga tetori 2004, EBRD vepronte si partner i Qeverisë duke marrë të drejtën e blerjes deri më 19.9% të aksioneve të ESM-së, nën kushte të njëjta të tenderit. Në prill të vitit 2006, shitblerja ishte caktuar për 70.1% të aksioneve të ESM-së, ndërsa pjesa e rezervuar për aksionet e EBRD-së mbeti e paprekur, si çështje e vendimeve të EBRD-së. Më vonë më 2006, banka hoqi dorë nga e drejta për blerjen e ndonjë aksioni të ESM-së, dhe më 04.10.2007 procesi i privatizimit të ESM-së përfundoi me EVN AG si blerëse e 90% të aksioneve.

EVN përfaqëson një kompani të shërbimeve publike të respektuar në Austri, dhe ajo fitoi tenderin me një çmim shumë të mirë prej 225 milionë euro dhe 96 milionë euro për investime.

Pas ristrukturimit më 2005, territori i prodhimit të energjisë elektrike është i mbuluar nga kompania me pronësi shtetërore, ELEM dhe një termocentral i vetëm 210 MW me djegie të naftës – TEC Negotino.

- Rezultatet e privatizimit

Inspektimi i kompanisë së pavarur për auditim KPMG theksoi që investimet në 'EVN Macedonia' për tre vjetët e fundit arritën vlerën 108,3 milionë eurove, që është 12,3 milionë euro më shumë se shumën e obliguar prej 96 milionësh në pajtim me kontratën e shitblerjes së ESM-së. Së bashku me Ernst & Young, ata theksojnë se investimet janë në rrjetin e shpërndarjes dhe në të gjitha sektorët, prej të cilave kualiteti i furnizimit me energji elektrike është përmirësuar.

"Investimet kontribuuan në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes dhe zvogëluan periodën e defekteve për 50%, përdërisa gjithashtu u përmirësua edhe efektshmëria teknike e rrjetit. Rreth 960 kompani lokale janë të angazhuara si bashkë-operatorë, kontraktorë dhe nënkontraktorë për EVN. Në të njëjtën kohë, investimet kanë haur disa qindra vende pune në kompani, gjë që i dha raste edhe personelit të ri me kualifikim", thotë njoftimi i EVN-së.

The procedure of privatizing the 45,125% remaining shares of Macedonian Telecommunication AD Skopje

Para 1 janarit 1997 paraardhësit e kësaj kompanie ofronin shërbimet e telekomunikacionit, postës, bankare dhe shërbime tjera në Republikën e Maqedonisë me emrin 'PTT Makedonija'. Ministria e Transportit dhe Komunikimeve, në emër të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, caktoi CIBC Wood Gundy Oppenheimer si këshilltar i privatizimit të 'Makedonski Telekomunikacii'. Në privatizim përfshihej shitja e një pjese të madhe të aksioneve të një investitor strategjik. CIBC Wood Gundy Oppenheimer, një bankë investimi ndërkombëtare me një prezencë të rëndësishme në Evropën Qendrore dhe Lindore, formoi një shoqëri të përbërë nga Squire Sanders L.L.P. & Dempsey dhe Coopers & Lybrand për të përfunduar të gjitha aspektet e privatizimit. Squire, Sanders & Dempsey është avokatura kryesore në kryerjet e privatizimit të telekomunikimit. Coopers & Lybrand është firma kryesore botërore sa i përket kontabilitetit të telekomunikimit dhe firmë këshilluese. Telekomunikimi maqedonas ishte shitur të kompania hungareze e telekomit MATAV. Sipas vendimit të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë në vitin 1996, 'PTT Macedonia' ishte ndarë në pjesë – 1) AD Telekomunikimi Maqedonas dhe 2) AD Posta Maqedonase, që hyri në forcë më 1 janar 1997. Si rrjedhojë ndodhi ndarja e postës nga telekomunikimi dhe telegrafi dhe ndarja e aseteve dhe përgjegjësisë të tyre. Në mars 1998, kompani u regjistrua si pronësi shtetërore në mënyrë që të fillonin përgatitjet për privatizim.

Më 15 janar të vitit 2000, Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe shoqëria e kryesuar nga operatori hungarez i telekomunikimeve MATAV, anëtar i grupit 'Deutsche Telecom', gjë që e bën MATAV aksionar me 51% të aksioneve, aksionarin më të madh të kompanisë (Tabela 1).

Duke filluar nga 1 korriku i vitit 2001 operacionet e aseteve të sektorit të telefonisë mobile të Telekomunikimit Maqedonas AD Shkup u transferuan në korporatën e

sapo themeluar Mobimak AD Shkup (kompani pasardhëse me 100% të pronësisë së Telekomunikimit Maqedonas AD Shkup).

Komisioni i privatizimit i Republikës së Maqedonisë, më 17.04.2006 sjelli vendimin për shitjen e aksioneve me pronësi shtetërore të Telekomunikimit Maqedonas AD Shkup. Çak i blerjes ishin 43,247,250 aksione me pjesëmarrje prej 45.125% (të mbeturat pas blerjes nga MATAV) nga kapitali nominal i Telekomunikimit Maqedonas AD Shkup.

TABELA 1: Struktura pronësore e Telekomunikimit Maqedonas AD Shkup dhe pjesëmarrja në vlerë si në vijim:

	Numri i aksioneve	Pjesëmarrja më përqindje	Pjesëmarrja me 000 EUR
MATAV – aksione të zakonshme	48, 877,780	51.00	310,834
International Financial Corporate – aksione të zakonshme	1,796,980	1.875	11,428
RM – aksione të zakonshme	45,164,020	47.125	287,217
RM – pjesa e artë 'golden shares'	1		1
Total – aksione të zakonshme	95,838,780	100.00	609,479
pjesa e artë	1		1

Aksionet me pronë shtetërore janë shitur përmes ankandit - bursës publike. Paguesa duhej të paguhej me para në dorë. Në qoftë se blerësi është i huaj, atëherë aksionet paguhesh në valutë të huaj. Shitja e aksioneve ishte realizuar gjatë periudhës 5-9 qershor 2006 përmes Bursës Maqedonase AD Shkup. Kufizimet në marrëveshjet e aksionarëve janë që Qeveria e Republikës së Maqedonisë nuk mund të shet më shumë se 10% të kapitalit të mbetur. Pas privatizimit, Republika e Maqedonisë mbetet pronar i 1,916,770 aksioneve të zakonshme apo 2% të numrit të përgjithshëm të Telekomunikimit Maqedonas, dhe gjithashtu pronar i pjesës së artë. Të hyrat nga privatizimi i Telekomunikimit Maqedonas u vendos të shkonin në buxhet të shtetit. Kjo krijoi një tepricë në buxhetin e vitit 2001.

Në vitin 2009 Ministria e Transportit dhe Komunikacionit dha njoftim rreth tenderit të dytë për çfarë edhe po kërkohet një konsulent që do të bëjë përgatitjen e studimit për modelin më të përshtatshëm për privatizimin e pjesës së artë të postave. Konsulenti duhet të propozojë modelin për privatizim brenda periudhës 6-mujore. Ky është njoftimi i dytë, pas atij të kaluarit që mbaroi në fund të vitit të kaluar, që u anulua për shkak që gjashtë kompanitë që kishin aplikuar nuk përmbushnin me kushtet dhe përcaktimet e përsëritura.

Interesimi i tyre për Postat maqedonase u shfaq nga posta gjermane dhe sllovene, dhe nga një kanadeze gjithashtu u përmend si kandidat. Gjashtë kompani kishin paraqitur ofertat e tyre, por Komisioni për procedurën e lëshimit të kontratës për tender publik nuk kishte zgjedhur kandidatin potencial shkaku që kompanitë nuk kishin përmbushur kushtet e paraqitura. Në pajtim me Ligjin për tender publik, tenderi i dytë ishte paraqitur për zgjedhjen e ekipit këshillues, njofton ministria.

Ministria kishte planifikuar që shitja të ekzekutohet në dy faza dhe të përfundohet para fundit të vitit 2009 apo në fillim të çerekut të parë të vitit 2010. Plani ishte që një pjesë e vogël e aksioneve të shitet, dhe sipas planit gjatë fazës së parë, 20.5% e aksioneve të shiten. Faza e dytë e privatizimit të pjesëshëm është që të shiten 49% të aksioneve, ndërsa pjesa më e madhe prej 51% të mbeten nën pronësi të qeverisë së shtetit. Menaxhmenti do të merret përsipër nga një kompani e huaj dhe Qeveria do të ketë pjesën e saj të aksioneve brenda kompanisë.

Koncesioni i aeroportit "Aleksandri i Madh" – Shkup dhe i aeroportit "Sh. Pauli dhe Apostle" – Ohër, dhe ndërtimi i një aeroporti kargo në Shtip.

Ministri i Transportit dhe Komunikimit në fillim të korrikut të vitit 2007 solli një vendim për zgjedhjen e ofertës më të favorshme për punësimin e një ekipi këshillues për përgatitjen e studimit me një model koncesioni të Aeroportit "Aleksandri i Madh" – Shkup dhe Aeroportit "Shën Pauli dhe Apostle" – Ohër. Në pajtim me nenet 33, 43 dhe 44 të Ligjit mbi Koncesionet dhe llojet e tjera të ortakërive publike-private („Official Gazette of the Republic of Macedonia" Nr. 07/08), vendimi i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për nisjen e një procedure për dhënien e koncesionit për ndërtimin, rikonstruktimin dhe operimin e aeroporteve, Komisioni për procedurën e dhënies me koncesion, me vendimin Nr.02-5084 nga ministri i Transportit dhe Komunikimit, shpalli ftesë publike.

Në shtator të vitit 2007, kontakti për shërbime konsulente u nënshkrua me ofertuesin më të favorshëm – kompaninë NACO B.V. nga Holanda, që është e obliguar brenda periudhës 6-mujore pasi kontrata të bëhet efektive, të përgatisë një studim me model për koncesion për zhvillimin e dy aeroporteve në regjion, mundësitë për përkrahje financiare për zhvillim dhe strategji për nevoja investuese të aeroporteve. Veç kësaj, ekipi këshillues është i obliguar të kontrollojë mundësitë urbanistike-hapësinore dhe trafike-aviacionare për ndërtimin e një aeroporti kargo në Shtip, të klasës 3D dhe mundësi vizuale.

Në dhjetor 2007, këshilltari dha një draft raport për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikimit dhe ai u miratua nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Qeveria e Republikës së Maqedonisë filloi procedurën për dhënien me koncesion për ndërtimin, rindërtimin dhe përdorimin e dy aeroporteve në Republikën e Maqedonisë dhe gjithashtu për ndërtimin e një aeroporti kargo në Shtip.

Proceset ndodhën gjatë vitit 2008. Më 29.02.2008 dhe 01.03.2008 u publikua shprehja e interesit për të gjithë pjesëmarrësit e interesuar për pjesëmarrje në proceset për dhënie me koncesion të dy aeroporteve dhe ndërtimin e një aeroporti kargo të ri në Shtip, lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikimit. Më 10.04.2008 u shpall thirrja publike për të gjitha entitetet e interesuara për paraqitjen e kërkesës

për pjesëmarrje në proceset për dhënie me koncesion të dy aeroporteve dhe ndërtimin e një aeroporti të ri kargo në Shtip. Më 19.05.2008 u njoftua një hapje publike e tenderit për dokumentacion në fazën e parë (shih shtojcën I).

Informata mbi dosjet për tender për fazën II "kërkesë për ofertë" lidhur me procedurën e dhënies me koncesion është adoptuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë në seancën e 104-të më 12 korrik 2008. Më datën 15 korrik u ndërmorën aktivitetet në vijim:

- Lëshimi i propozimit për kërkesë
- Paraqitja e dokumentacionit për tender për fazën II RFP dhe
- Dhënia e dhomës së të dhënave për ofertuesit e kualifikuar.

Afati për paraqitjen e pyetjeve për ofertuesit e kualifikuar në RFP ishte caktuar për datën 6 gusht, dhe brenda këtyre dy ditëve u mbajt një konferencë në Shkup për ofertuesit e kualifikuar dhe vizitë për vendndodhje. Vendimi për seleksionimin e koncesionarit në procesin për dhënie me koncesion të aeroporteve dhe ndërtimin e një aeroporti të ri kargo në Shtip u miratua në seancën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë më 29 gusht 2008 dhe u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë Nr. 108/08. Njoftimi i fituesit të tenderit ndodhi më 02 shtator 2008, regjistruar si "TAV Maqedonia" DOOEL. Kompania turke TAV nënshkroi një marrëveshje me Qeverinë e Maqedonisë duke qenë ofertues i vetëm për tender. Marrëveshja e koncesionit hyn në fuqi brenda periudhës së 341 ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes. Koncesioni i nënshkruar nënkupton një dhënie me koncesion për periudhën 20-vjeçare. Aeroportet duhet të jenë gati brenda tre vjetëve.

Bashkë me tender, TAV fitoi të drejtën për të udhëhequr dy aeroportet më të mëdha ndërkombëtare të Maqedonisë për 20 vjet. Kompania premtoi një investim prej 200 milionë eurosh në këto aeroporte. Parashikohet që modernizimi i punës të përfundojë brenda 20 muajve në aeroportin e Shkupit dhe 12 muajve në atë të Ohrit. Ndërtimi i terminalit kargo do të përfundojë për tre vjet.

Si një investim me vlerë më shumë se 250 milionë euro, dhënia me koncesion për ndërtimin e aeroportit të aeroporteve të Shkupit, Ohrit dhe Shtipit paraqet një reformë të rëndësishme në fushën e infrastrukturës. Kështu që, trafiku ajror në Republikën e Maqedonisë mund të mbajë trendin e tanishëm të rritjes së madhe të trafikut ajror dhe këto investime do të kontribuojnë gjithashtu në rritjen e sektorit të ndërtimit të Republikës së Maqedonisë.

Shtojca 3:

Tabela 1. Përmbledhje e privatizimeve të ndërmarrjeve telekomunikuese në ekonomitë në tranzicion ndërmjet viteve 1993 dhe fundit të vitit 2002

Vendi	Kompania	Data	(US\$ Mil-ion)	Mënyra e shitjes	Pjesa e shitur
Shqipëria	Albanian Mobile Communication	Gusht 00	\$128.6	Shitje e asetëve ¹	85%
Bulgaria	Bulgarian Telecommunications Company	Prill 00	\$600	Shitje e asetëve	51% ²
Kroacia	Croatian Telecom	Tetor 99	\$850	Shitje e asetëve	35% ³
Republika Çeke	Cesky Telecom	Korrik 95	\$1,460	Shitje e asetëve	27% ⁴
Republika Çeke	Ceske Radiokomunikace	Shtator 97	\$11.5	Shitje e asetëve	20.8%
Republika Çeke	Ceske Radiokomunikace	Qershor 98	\$134	SIP	19%
Estonia	Estonian Telecom	Shkurt 99	\$221	SIP	23.7%
Hungari	Matav	1993	\$875	Shitje e asetëve	30%
Hungari	Matav	1995	\$852	Shitje e asetëve	—
Hungari	Matav	Nentor 97	\$1,200	SIP	17%
Kazakistan	Kazakhtelecom	1997	\$370	Shitje e asetëve	—
Letonia	Lattelecom	Janar 94	\$160	Shitje e asetëve	49%
Lituania	Lithuanian Telecom	Qershor 00	\$160	SIP	25%
Maqedonia	Macedonian Telecommunications	Dhjetor 00	\$326 ⁵	Shitje e asetëve	51%
Polonia	PZT Telekom; Teletra	1993	\$37	Shitje e asetëve	80%
Polonia	Telekomunikacja Polska (TPSA)	Nëntor 98	\$1,020	SIP	15%
Polonia	TPSA	Korrik 00	\$4,300	Shitje e asetëve	35% ⁶
Romania	Rom Telecom	Nëntor 98	\$675	Shitje e asetëve	35% ⁷
Rusia	Svyazinvest	1997	\$1,870	Shitje e asetëve	25% ⁸
Rusia	Mobile Telesystems (MTS)	Qershor 00	\$384	SIP	—

Serbia	Serbia Telecom	Qershor 97	\$869	Shitje aseteve	e 49% ⁹
Sllovakia	Slovak Telecom	Korrik 00	\$950	Shitje aseteve	e 51% ¹⁰
Ukraina	Ukrainian Mobile Communication	Nentor 02	\$194	Shitje aseteve	e 57.67% ¹¹

(Footnotes)

- Pagesa është bërë në dy pjesë: fillimisht \$85.6 milion dhe pastaj edhe \$85.6 milion pas gjashtë muajve. Pjesët i janë shitur kompanisë Cosmote/Telenor, një konsorcium ndërmjet OTE (Greqi) dhe Telenor (Norvegji). Blerësit janë zotuar të investojnë edhe \$120 milion që të zgjerojnë rrjetin dhe të përmirësojnë cilësinë.
- Pjesët i janë shitur konsorciumit OTE (Greqi) dhe KPN (Holandë). Blerësit janë pajtuar që të investojnë edhe \$350 milion përgjatë tre viteve dhe të ndajnë \$200 milion përfitime me autoritetet e qeverisë lokale.
- Pjesët i janë shitur Deutsche Telekom.
- Pjesët i janë shitur konsorciumit ndërmjet Swisscom dhe KPN.
- Blerësi, Matev nga Hungaria ka premtuar që të bëjë investime kapitale në vlerë prej \$229 milion.
- Pjesët i janë shitur konsorciumit të udhëhequr nga France Telecom. France Telecom ka blerë 25% të aksioneve përderisa partneri i tij nga Polonia, konglomerati privat Kulczyk Holding, ka blerë 10% të mbetura të kompanisë.
- Pjesët i janë shitur OTE nga Greqia e cila ka marrë kontrollin menaxhues të Rom Telecom.
- 25 % plus një aksion i është shitur konsorciumit Mustcom, i cili përfshinë George Sorosin, dhe grupin financiar Interos, grup i udhëhequr nga "oli garki" Vladimir Potanin.
- Pjesët i janë shitur OTE nga Greqia dhe Stet nga Italia.
- Pjesët i janë shitur Deutsche Telekom
- Kompania ruse Mobile Tele Systems (MTS) ka blerë këtë pjesë që përfshinë 25% të aksioneve të Ukrtelecom dhe ka nënshkruar marrëveshje opsionale për të blerë pjesën e mbetur prej 42.33% për \$142.6 milion ndërmjet viteve 2003–2005.

Burimi: Pjesë nga tabela Table 8.4 (Megginson, 2005)

Shënim: Kjo tabelë paraqet të dhëna kyçe lidhur me privatizimin e ndërmarrjeve telekomunikuese të bëra nga qeveritë e disa vendeve në ekonomitë e tranzicionit. Metoda e shitjes është shitja përmes aksioneve (SIP) apo shitje të aseteve.

REFERENCAT DHE BIBLIOGRAFIA

Andrew, D. and Dochia, S. (2006), "The growing and evolving business of private participation in airports-New trends, new actors emerging", Grid-lines, Public-Private Infrastructure Advisory Facility (PPIAF), Note no. 15, September

Austrian Energy Agency (<http://www.energyagency.at>)

Berlage, M., (1995), "Telecommunications Development in Central and Eastern Europe", *International Political Science Review*, Vol. 16, No. 3, *Communication and Political Geography in a Changing World*, pp. 283-303
 Bielecki, J. and Desta, M. G., (2004), "Electricity trade in Europe: review of economic and regulatory challenges", *Kluwer Law International*

Cheviakhova, E., Friebel, G., Guriev, S., Pittman, R. and Tomová, A. (2007) *Railroad Restructuring in Russia and Central and Eastern Europe: One Solution for All Problems?* (Available on URL: http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=623963, accessed September 2009).

Choi, J. P., (1995), "Telecommunications Reform in Central and Eastern Europe", *Institute for Advanced Studies / East European Series No. 28*

Demsetz, H. (1967), *Why Regulate Utilities?*, *Journal of Law and Economics*, 55-65.

Departamenti i thesarit (2009) 'raporti gjysmë-vjetor', *Ministra e Ekonomisë dhe Financave, Kosovë*

Departamenti i thesarit; *Ministra e Ekonomisë dhe Financave, Expenditures From Kosovo Consolidated Budget to POEs Year 1999-2007*

EBRD, (2008), "Transition Report: Growth in Transition", *European Bank for Reconstruction and Development, London*

European Commission - World Bank, (2007), "Deeper Integration and Trade in Services in the Western Balkans- Building Blocks for a Trade-Driven Growth Strategy", *Office for South East Europe*

Guasch, J. L. and Spiller, P. (1999), *Managing the Regulatory Process: Design, Concepts, Issues and the Latin America and Caribbean Story*, Washington, D.C.: The World Bank.

Guasch, J. L., Laffont, J.J. and Straub, S. (2003), *Renegotiation of Concession Contracts in Latin America*, *Policy Research Working Paper no. 3011*,

Washington, D.C.: The World Bank,

Guasch, J.L. (2004), *Granting and Renegotiating Infrastructure Concessions: Doing it Right*, Washington D.C.: The World Bank

Harris, C. (2002), *The Beginning of the End or the End of the Beginning? A Review of Private Participation in Infrastructure in Developing Countries*, Washington, D.C.: The World Bank.

IBRD / World Bank, (2008), "Western Balkan integration and the EU-An agenda for Trade and Growth", The World Bank, Washington

ILO, (1999), "Report for discussion at the Tripartite Meeting on Managing the Privatization and Restructuring of Public Utilities", International Labour Office, Geneva, 12-16 April

Juan, J. E., (1996), "Privatizing Airports—Options and Case Studies", *Public Policy for the Private sector*, The World Bank, Note no. 82, June

Levy, B. and Spiller, T. P., (1993), "Regulation, Institutions, and Commitment in Telecommunications: A Comparative Analysis of Five Country Studies," *Proceedings from the World Bank Annual Conference on Development Economics*, pp. 215-251

Lieberman, I. W., (2008), "Privatization in Transition Economies: The Ongoing Story", *Contemporary Studies in Economic and Financial Analysis*, Volume 90, 1-8

Meggison, W. L., (2005), "The Financial Economics of Privatization", Oxford University Press, London.

Newbery, D. M. (2000), *Privatization, Restructuring and Regulation of Network Utilities*, Cambridge, Mass.: MIT Press.

Newbery, D. M. G., (1999), "Privatization, Restructuring, and Regulation of Network Utilities", *Walras-Pareto Lectures*; the MIT Press, Cambridge, Massachusetts

Raporti i paralajmërimet të hershëm (numra të ndryshëm), 'Sistemi i paralajmërimet të hershëm UNDP- Kosovë

Riinvest Institute (2001) – 'Ndërmarrjet shoqërore dhe privatizimi i tyre,'- Qershor 2001, Prishtina

Riinvest Institute (2002) – 'Privatizimi i NSH-ve dhe reforma e shërbimeve publike ne Kosovë'- Qershor 2002, Prishtina

Riinvest Institute (Forum 2015) (2004) – 'Privatizimi në Kosovë: Përparimet dhe ngecjet,'- 2004, Prishtinë

Riinvest Institute (Forum 2015) (2004) – 'Statusi i pronës shoqërore ne Kosovë: kontestet dhe privatizimi'– 2004, Prishtina

Riinvest/'Forum 2015' (2008) 'Privatizimi në Kosovë: një gotë gjysmë bosh apo gjysmë e mbushur?'

Sallai, G., Schmideg, I., Lajtha, G., (1996), "Telecommunications in Central and Eastern Europe Similarities, peculiarities and trends of change in the countries of transition", Telecommunications Policy, Vol. 21, No. 5, pp. 325-340

South East Europe Wholesale Market Opening (2009) - Pöyry Energy Consulting and Nord Pool Consulting, March 2009

UNDP (2004) – 'Raporti i korrupsionit në Kosovë' UNDP - Kosovë

